



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj



Ekonomia e nënvlerësuar

“Gratë nuk kanë kohë ta ndryshojnë kombin: janë të zëna me punët e shtëpisë”



Ekonomia e nënvlerësuar

“Gratë nuk kanë kohë ta ndryshojnë kombin: janë të zëna me punët e shtëpisë”

Të drejtat e autorit © 2023 Demokracia për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D , GADC, ISSP, CRPM dhe BFPE .

Ky hulumtim është përgatitur nga:

Autorët:

- ~ Instituti Demokracia për Zhvillim, Dr. Judita Krasniqi Hajdari (Kosovë)
- ~ Qendra për Hulumtime dhe Politikëbërje, Kristijan Trajkovski (Maqedoni e Veriut)
- ~ Instituti për Studime Strategjike dhe Prognoza, Anđela Lučić (Mali i Zi)
- ~ Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Mirela Arqimadriti (Shqipëri)
- ~ Fondacioni BFPE për Shoqëri të Përgjegjshme, Svetlana Stefanović dhe Mirjana Đorđević (Serbi)

Përgjegjësia: Të gjitha pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë medoemos qëndrimet e Ambasadës Norvegjeze në Prishtinë.

Mirënjohje:

D4D dëshiron të shpreh falënderim për Ambasadën Norvegjeze në Prishtinë për mbështetjen financiare të projektit "Shfrytëzimi i zhvillimit: Rritja e qasjes së grave në punësim" në kuadër të të cilit është realizuar ky projekt hulumtues.

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
METODOLOGJIA	13
KOSOVA	14
SHQIPËRIA	24
MAQEDONIA E VERIUT	33
MALI I ZI	46
SERBIA	54

Lista e grafikave

Grafiku 1. Me cilat punë të shtëpisë merreni më shumë?	19
Grafiku 2. Kush duhet të merret me punët e shtëpisë?	20
Grafiku 3. Kush kujdeset (apo duhet të kujdeset) për fëmijët?	20
Grafiku 4. Ndarja e punëve të shtëpisë	28
Grafiku 5. Ndarja e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët	29
Grafiku 6. Aktivitetet kryesore të përditshme	30
Grafiku 7. Të anketuarit sipas gjinisë	40
Grafiku 8. Të anketuarit sipas moshës	40
Grafiku 9. Të anketuarit sipas shkollimit	41
Grafiku 10. Të anketuarit sipas gjendjes ekonomike	42
Grafiku 11. Me cilat punë të shtëpisë merreni më shumë?	43
Grafiku 12. Kush duhet të merret me punët e shtëpisë?	44
Grafiku 13. Numri i orëve të kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi, sipas aktivitetit (gratë)	52
Grafiku 14. Kujdesi pa pagesë dhe punët e shtëpisë të kryera nga gratë dhe burrat, përkatësisht (në €)	53
Grafiku 15. Të anketuarit sipas gjinisë	56
Grafiku 16. Të anketuarit sipas moshës	56
Grafiku 17. Të anketuarit sipas statusit të punësimit	57
Grafiku 18. Të anketuarit sipas shkollimit	57
Grafiku 19. Të anketuarit sipas vendit të banimit (zonë urbane/zonë rurale)	58

Shkurtesat

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AFP	Anketa e fuqisë punëtore
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
PBB	Prodhimi i brendshëm bruto
COVID-19	Sëmundja e Coronavirusit 2019
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
BE	Bashkimi Evropian
ESHS	Enti Shtetëror i Statistikave
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
FES	Friedrich Ebert Stiftung
D4D	Instituti Demokraci për zhvillim
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
MCC	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë

Përmbledhje ekzekutive

Sektorët ekonomikë pjesë të ekonomisë së kujdesit përfshijnë punën e paguar dhe punën e papaguar në kujdesin ndaj fëmijëve, të moshuarve dhe në kujdesin shëndetësor, dhe janë sektorët ekonomikë që po zgjerohen më së shpejti në nivel global. Përveç se përbëjnë rreth 70% të punësimit në vendet e OECD, ILO parashikon që punësimi në ekonominë e kujdesit do të rritet nga 206 milionë deri në 358 milionë të punësuar në këtë sektor në vitin 2030.

Një pjesë e madhe e punës së kujdesit kryhet pa pagesë dhe shpesh nga anëtarët e familjes. Hulumtimet kanë treguar se puna e përkujdesjes zakonisht kryhet nga gratë, kështu që puna që kryhet nga gratë vazhdon të jetë e zhvlerësuar, nuk njihet, nuk pranohet, nuk duket sa duhet dhe nuk llogaritet si kontribut në ekonominë kombëtare. Ballkani Perëndimor vazhdon të karakterizohet me ndarje të thellë të tregut të punës, me pjesëmarrje të pabarabartë të grave në fuqinë punëtore, ku Kosova shfaqet me përqindjen më të ulët të grave aktive në tregun e punës me vetëm 21.2%, ndërsa 78% e grave mbeten joaktive. Sipas anketës për përdorimin e kohës të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), 32.2% e grave janë joaktive sepse kujdesen për fëmijët, 16% nuk besojnë se ka vende punë për to dhe 2.2% sepse kujdesen për të moshuarit.

Treguesit e tregut të punës në Kosovë tregojnë se 89.3% e grave janë punëtore, ndërsa vetëm 3.8% janë punëdhënëse. Më pak se 10% e bizneseve drejtohen nga grave ose janë në pronësi të tyre dhe 46.9% e grave kanë vende pune të paqëndrueshme. Paralelisht, gratë shpenzojnë 7.2 orë në punët e shtëpisë dhe të kujdesit në familje krahasuar me 2.5 orë që i shpenzojnë burrat. Sipas anketës së D4D-së, gratë kryesisht janë të zëna me pastrim (47%), gatim (21%) dhe kujdesin për fëmijët (21%), ndërsa vetëm 4.5% e grave nuk do të merreshin me punët e shtëpisë krahasuar me 39% e burrave. Mentaliteti patriarkal mbizotëron me të madhe në radhët e grave dhe të burrave. Ndonëse shumica e të anketuarve në anketën e D4D konsiderojnë se gratë, ashtu si edhe burrat duhet t'i ndajnë punët e shtëpisë në mënyrë të barabartë, gratë nuk besojnë se burrat duhet të jenë përgjegjës, dhe gratë vazhdojnë të besojnë se kujdesi ndaj fëmijëve dhe punët e shtëpisë janë punë e grave.











Ndonëse Shqipëria ka përqindjet më të larta të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës sipas Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), 22.8% e grave kryejnë punë të papaguar në familje krahasuar me 13.1% të burrave. Sipas shkaqeve të joaktivitetit, gratë mbeten jashtë fuqisë punëtore kryesisht për shkak se janë të zëna me punë të papaguara në shtëpi (18,8 %), ose sepse e vijnë shkollën (20,9 %). Nga ana tjetër, vetëm 0,6 % e burrave deklarojnë se janë punët e shtëpisë si arsye e joaktivitetit të tyre, ndërsa 25,7 % janë studentë ose nxënës. Gratë kryejnë 5,46 orë në ditë punë pa pagesë, ndërsa ndarja gjinore e punës së papaguar është 21,74% te gratë dhe vetëm 3,47% te burrat. Ndërkohë, edhe pse mbi 95% e grave dhe r burrave besojnë se si gratë, ashtu edhe burrat duhet t'i ndajnë punët e shtëpisë dhe kujdesin ndaj fëmijëve, burrat në masë më të madhe se gratë vazhdojnë të besojnë se kjo është punë e grave.


Në Maqedoninë e Veriut, anketa e përdorimit të kohës tregon rolet tradicionale gjinore në ndarjen e punës. Gjersa gratë i kushtojnë vetëm 7.3% punës me pagesë dhe 15.6% punëve shtëpiake, burrat shpenzojnë 13.5% të kohës në punët me pagesë dhe vetëm 5% në punët e shtëpisë. Gratë vazhdojnë të jenë të përqendruara në sektorin e prodhimit, të shitjes me shumicë dhe pakicë, në sektorët e shëndetësisë dhe të arsimit, si dhe në bujqësi, ndërsa burrat janë të përqendruar në ndërtim, miniera, administratë dhe mbrojtje, dhe profesione të tjera që konsiderohen si "të përshtatshme" për burrat. Të dhënat e anketës hulumtuese tregojnë se 42.4% e të anketuarve janë të përqendruar kryesisht në pastrim dhe 18.2% në kujdesin ndaj fëmijëve. Gratë janë të përqendruara në gatim, pastrim dhe kujdesin ndaj fëmijëve, ndërsa të dhënat tregojnë se të anketuarit burra nuk angazhohen fare në kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve. 93.9% e të anketuarve besojnë se si gratë, ashtu edhe burrat duhet t'i kryejnë punët e shtëpisë, ndërsa 6.1% mendojnë se kjo është punë e grave. Asnjë nga të anketuarit nuk beson se punët e shtëpisë janë punë të njeriut.

Sipas të dhënave të Malit të Zi, 15% e grave shpenzojnë më shumë se 4 orë duke u kujdesur për fëmijët dhe nevojat e familjes. Ekuivalenti monetar i kujdesit të papaguar dhe i punëve shtëpiake që kryhen nga gratë në Mal të Zi vlerësohet të arrijë në 122.3 milionë euro vetëm për tre muaj të vitit 2020, ndërsa ekuivalenti monetar i kujdesit të papaguar dhe i punëve shtëpiake që kryhen nga burrat arrin në 63.5 milionë euro. Kjo d.m.th., se gratë bënin 90% më shumë punë në fushën e kujdesit të papaguar dhe punë të shtëpisë sesa burrat. Nëse këto të dhëna parashikohen për 12 muaj, mund të vihet në përfundim se gratë gjeneruan ekuivalentin monetar të kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi prej 489 milion euro ose 10% të PBB-së, ndërsa burrat gjeneruan 254 milion euro ose 5% të PBB-së së Malit të Zi për vitin 2019.

Në Serbi, treguesit e tregut të punës tregojnë ndarjen gjinore të sektorëve ekonomikë, gjersa gratë shpenzojnë më pak kohë në punët e paguara (2.23 orë) sesa burrat (3:37). Të dhënat e anketës hulumtuese se kush duhet t'i kryejë punët e shtëpisë, 2,5% janë përgjigjur gratë, 0% kanë thënë burrat dhe 97,9% kanë thënë se duhet t'i bëjnë të dyja palët. Kur u pyetën se kush kujdeset për fëmijët, 1% thanë baballarët, 20% nënat dhe 79% thanë të dyja palët. Kur u pyetën se kush duhet të kujdeset për fëmijët, 0% thanë baballarët, 1% thanë nënat dhe 99% thanë të dyja palët. Ndërkohë, të dhënat cilësore nxjerrin në pah nevojën e edukimit të brezit të ri mbi ndikimin e stereotipeve gjinore në zhvillimin ekonomik.

Me cilën punë të shtëpisë merreni më së shumti?

		Gatimi	Pastrimi	Kujdesi për fëmijët	Kujdesi për të moshuarit	Asnjërën	Të tjera
Kosova		21.3%	47.2%	21.3%	4.5%	4.5%	5.6%
		4.3%	4.3%	34.7%	0%	39.1%	8.7%
Shqipëria		34.2%	39.4%	21.2%	4.14%	0.5%	0.5%
		26.3%	15.7%	15.7%	10.5%	26.3%	5.2%
Maqedonia e Veriut		4.16%	41.7%	29.7%	4.16%	16.6%	4.16%
		37.5%	50%	0%	0%	12.5%	0%
Mali i Zi		25%	35%	15%	0%	25%	0%
		13.3%	0%	13.3%	6.6%	66.6%	0%
Serbia		9.7%	24.2%	26.9%	1.4%	3.7%	33.9%
		14.2%	14.2%	21.4%	3.5%	10.7%	35.7%













Kush duhet të merret me punët e shtëpisë?

	Gratë	Burrat	Të dyja palët
Kosova		2.3%	97.7%
		21.7%	82.6%
Shqipëria		2.3%	96.5%
		28.5%	71.4%
Maqedonia e Veriut		4.16%	95.8%
		12.5%	87.5%
Mali i Zi		0%	100%
		13.3%	86.6%
Serbia		2.3%	97.6%
		0%	100%





Kush kujdeset (duhet të kujdeset) për fëmijët?

	Nënat	Baballarët	Të dyja palët
Kosova	 9%	0%	89.7%
	 21.7%	0%	78.2%
Shqipëria	 8.1%	1.16%	90.7%
	 21.4%	0%	78.6%
Maqedonia e Veriut	 8.3%	0%	91.6%
	 0%	0%	100%
Mali i Zi	 20%	0%	80%
	 20%	0%	80%
Serbia	 22.3%	1.3%	76.2%
	 7.14%	0%	92.8%



Metodologjia

Mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre në këtë hulumtim është kryer nga të gjitha organizatat partnere pjesëmarrëse në këtë hulumtim. Është kryer një analizë e thellë e gjendjes ekzistuese mbi ekonominë e kujdesit dhe punën e papaguar të grave në secilin vend gjegjë, ku analizohet hulumtimi në zyrë dhe shqyrtimi nga aspekti ligjor i ligjeve, i politikave dhe i rregulloreve për punën e papaguar, përfshirë këtu ekonominë e kujdesit.

Më tej, secili prej këtyre vendeve ka kryer hulumtimin e vet mbi ekonominë e kujdesit, duke mbledhur të dhëna origjinale për këtë hulumtim. Në secilin prej këtyre vendeve janë kryer intervista dhe mbajtur fokus grupe për ta mbështetur anketën online mbi ekonominë e kujdesit, e cila synonte të mblidhte informata mbi perceptimin e grave dhe burrave mbi punën e papaguar dhe ekonominë e kujdesit. Duke përdorur Google Forms, secili prej këtyre vendeve ka shpërndarë serinë e njëjtë prej 10 pyetjesh.

Edhe pse me pyetësor synohet të ofrohet një përshkrim momental i asaj që njerëzit e mendojnë dhe e besojnë për punën e përbashkët, punën e papaguar, kush duhet ta kryejë atë dhe kush është përgjegjës për të, në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Serbi, ky pyetësor shpalos edhe **kufizimet** e këtij hulumtimi, pasi numri i të anketuarve nuk është i barabartë sa i përket gjinisë, moshës, arsimit apo në ndonjë variabël tjetër të pavarur. Kështu që, ai nuk mund të konsiderohet përfaqësues.

Kosova

Hyrje

...” Nëse të gjithë punonjësit e kujdesit në botë do të ishin një ekonomi kombëtare, ajo do të ishte ndër më të mëdhatë në botë, për sa i përket orëve të realizuara të punës. Ajo po ashtu do të përbëhej kryesisht nga gratë, dhe ato do të ishin kryesisht të papaguara.”¹

Çfarë është kujdesi dhe çfarë përfshin puna e kujdesit në kuadër të saj, ka qenë debat i gjatë mes studiuesve. Sipas England *et al* “puna që ofron shërbime ballë për ballë që zhvillojnë aftësitë e marrësit”² duke përfshirë aspektet mendore, fizike ose emocionale të punës së kujdesit, ndërsa sipas Folbre, është kujdesi i ofruar për përmbushjen e nevojave të personave të varur, diçka që ata nuk mund ta bëjnë për veten e tyre,³ çfarë do ta përkufizonte punën e kujdesit të drejtpërdrejtë ose përkujdesjen ndaj fëmijëve të vegjël. Megjithatë, ekziston një gamë më e gjerë punësh, si: pastrimi, përgatitja e ushqimit ose larja e rrobave që janë pjesë e punës së kujdesit dhe konsiderohen si përkujdesje jo-e-drejtpërdrejtë ndaj fëmijëve të vegjël.⁴

Bazuar në këto përkufizime, kujdesi që prindërit apo kujdestarët e tjerë ia japin familjes, fëmijëve apo të moshuarve, është një pjesë e rëndësishme e ekonomisë së kujdesit, që është një sektor i rëndësishëm dhe gur themel i jetës sociale dhe ekonomike.⁵ Kështu, ekonomia e kujdesit është sektor ekonomik i profilizuar në ofrimin e kujdesit për popullsinë aktuale dhe të ardhshme, si dhe përfshin kujdesin ndaj fëmijëve, arsimin, kujdesin shëndetësor, kujdesin personal, punën shtëpiake, kujdesin për të moshuarit dhe shërbime të tjera të ngjashme në forma me pagesë dhe pa pagesë, në ekonominë formale apo atë jo formale.⁶

Megjithatë, një pjesë e madhe e punës së kujdesit kryhet pa pagesë dhe shpesh nga anëtarët e familjes. Për më tepër, kjo punë nuk përfshihet në PBB-në kombëtare, ku llogaritet vetëm puna e paguar në treg. Sipas profesoreshës Jocelyn Olcott, kujdesi mund të ndahet në kujdesin që është pjesë e tregut dhe atë që nuk është pjesë e tij. Duke qenë se puna e papaguar nuk është pjesë e PBB-së dhe as nuk llogaritet në rritjen ekonomike, kështu që në lëmë jashtë një pjesë të madhe të aktiviteteve ekonomike. Sipas saj, “Kujdesi nuk vlerësohet sepse është punë e grave. Çdo gjë që bëjnë gratë zhvlerësohet”.⁷

Sektorët ekonomikë që janë pjesë e ekonomisë së kujdesit dhe që përfshijnë punën e paguar dhe të papaguar, si: fëmijët, të moshuarit dhe kujdesi shëndetësor, janë sektorët ekonomikë që po zgjerohen më së shpejti në nivel global. Sipas OECD-së, ajo përbën 70% të punësimit dhe të PBB-së në vendet e OECD-së, ndërsa në vendet me të ardhura mesatare, ajo përbën 60% të PBB-së.⁸ Ndërkohë, sipas ILO-s, punësimi në ekonominë e kujdesit do të rritet nga 206 në 358 milionë në vitin 2030 dhe akoma më shumë, nëse OZHQ-të e KB-ve që lidhen me arsimin, barazinë gjinore, shëndetësinë dhe kujdesin do të zhvillohen në politika nga qeveritë nëpër botë.⁹

Gjersa Ballkani Perëndimor ka pjesëmarrjen më të ulët të grave në fuqinë punëtore në Evropë, Kosova ka përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për tremujorin e katërt 2022 tregojnë se vetëm 21.2% e grave janë pjesëmarrëse aktive në tregun e punës, 78.8% janë joaktive dhe vetëm 17.1% janë të punësuar.¹⁰ Në veçanti hendeku gjinor në treguesit e tregut të punës është i dukshëm, pasi në Anketën e Fuqisë Punëtore të vitit 2022, vetëm 22% e grave janë pjesëmarrëse aktive në tregun e punës, krahasuar me 55.5% të homologëve të tyre burra. Pasi që 78% e femrave janë joaktive, vetëm 44.5% e burrave i përkasin kategorisë së njëjtë, dhe ndonëse 16.5% e grave kërkojnë punë aktive, por mbeten të papuna, kjo % është vetëm 11% për burrat në tregun e punës në Kosovë.

Edhe pse korniza ligjore në Kosovë e garanton barazinë gjinore në të gjitha sferat, shoqëria vazhdon të udhëhiqet me norma patriarkale. Në këtë drejtim, nga gratë pritet t'i marrin përsipër detyrat e tyre si shtëpiake dhe rolet e kujdesit, gjë që bëhet pengesa kryesore për angazhimin e grave në punë me pagesë dhe në tregun e punës. Prandaj, shoqëria vazhdon t'u diktojë grave pritshmëritë e ciklit jetësor të tyre. Sipas Studimit të FES-it mbi Gratë në Kosovë, për 74% të grave të anketuara, gjëja më e rëndësishme në jetë është të kenë fëmijë, ndërsa dëshira më e vogël e tyre është pjesëmarrja në jetën politike (7%).¹¹

Anketa e përdorimit të kohës në Kosovë e fundit është kryer në vitin 2018 në shkallë më të gjerë kombëtare, duke sjellë kuptim më të thellë të gjendjes lidhur me punën e papaguar në Kosovë. Ndërkohë, janë kryer edhe studime të tjera mbi pozitën e gruas në tregun e punës për punën e papaguar në periudha të veçanta, si ai i D4D-së në 2020 gjatë gjendjes së pandemisë COVID-19, ku realiteti i ri i krijuar për shkak të kufizimeve nga pandemia zbuloi shtresat e shumta të marginalizimit të grave, si dhe masën e punës së papaguar dhe të barrës që ato mbajnë.

Ky hulumtim synon të tregojë se pjesa e madhe e punës së papaguar që kryhet nga gratë çdo ditë, i mban ato larg tregut të punës dhe punës me pagesë, e pengon fuqizimin e tyre ekonomik, pjesëmarrjen e barabartë të grave në jetën publike, por edhe kontributin e tyre në ruajtjen e ciklit të jetës në aspektet sociale dhe ekonomike në Kosovë, pra që mbetet e padukshme dhe e pa llogaritur. Kështu që, gratë mbeten të pavlerësuara sa duhet dhe të marginalizuara, pasi kontributi i tyre është pjesë - e pjesës së nënvlerësuar të ekonomisë së Kosovës. Për ta analizuar situatën në Kosovë, do të përdoren të dhënat nga hulumtimi ekzistues, nga D4D dhe OSHC-të dhe institucionet e tjera, vendore dhe ndërkombëtare, të dhënat nga anketat online të kryera për këtë hulumtim, nga fokus grupet dhe metodat tjera cilësore të hulumtimit.

Puna e kujdesit e grave dhe punësimi i tyre në sektorin publik dhe atë privat

Në nivel global, gratë dhe vajzat kontribuojnë në më shumë se 70% të orëve gjithsej të shpenzuara në përkujdesje, si ato të paguara, ashtu edhe ato të papaguara, ndërsa ato përfaqësojnë më shumë se 75% të kohës së shpenzuar në punët e kujdesit të papaguar. (2,3). Sipas Qendrës Wilson, nëse punonjësve të kujdesit pa pagesë do t'u paguhej një pagë minimale për punën e tyre, kontributi i tyre në ekonominë globale do të ishte afërsisht 11 trilion dollarë në vit. (9) Ndërkohë, një studim i kryer nga D4D në vitin 2015 tregoi se nëse gjysma e grave joaktive në Kosovë do të punësoheshin, kjo do ta rriste PBB-në e vendit për 30%.¹² Në vitin 2022, hulumtimi tregoi se gjithsej vlera e punës së kujdesit të papaguar në Kosovë vlerësohet në 33% të PBB-së së vendit.¹³

Dhënia e kujdesit fillon që në lindje. Ndërkohë, puna e kujdesit që kryhet nga gratë shpesh lihet jashtë analizës ekonomike dhe lihet jashtë kontributi në shoqëri, siç lihet jashtë edhe lidhja e saj me sektorë të tjerë të ekonomisë.¹⁴ Ekonomia e kujdesit që lidhet me punën e paguar dhe të papaguar siç janë punët e shtëpisë dhe kujdesi për familjet, fëmijët dhe pleqtë ndikon në aftësinë e grave për t'u rritur në aspektin ekonomik dhe të barazisë gjinore dhe i pengon ato të fitojnë më shumë të ardhura. Megjithatë, ndonëse ekziston numri i ulët i grave të punësuar në Kosovë, ato nuk paguhen në mënyrë të barabartë sikurse homologët e tyre burra. Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare që e mbështesin këtë pretendim, sipas Gashi & Adnett, gratë me të njëjtin arsim apo përvojë pune, fitojnë 6.1% më pak në orë se homologët e tyre burra.¹⁵

Treguesit e tregut të punës shpalosin se gratë janë të diskriminuara në të gjitha aspektet e pjesëmarrjes së tyre. Duke qenë se gratë janë të përfaqësuara dobët në tregun e punës, të dhënat e vitit 2022 nga ASK-ja tregojnë se 89.3% e grave janë punëtore, ndërsa vetëm 3.8% e grave të vetë-punësuar janë punëdhënëse. Sipas USAID-it, më pak se 10% e bizneseve në Kosovë udhëhiqen ose janë në pronësi të grave, ndërsa vetëm 3% e kredive për biznes shkojnë për gratë, dhe për shkak të normave sociale dhe kulturore, gratë përballen me më shumë pengesa për hapjen ose mbajtjen e një biznesi.¹⁶

Në Kosovë, 13.3% e të punësuarve kanë vende pune të paqëndrueshme, prej tyre 6.9% janë gra. Megjithatë, më e rëndësishmja, 46.9% e vendeve të paqëndrueshme të punës të grave janë si punëtore të shërbimeve dhe të shitjeve, nga të cilat 26.7% janë punëtore pa pagesë në familje. Në 8.4 % më shumë gra me arsim të lartë punojnë si punëtore pa pagesë në familje, ndërsa për dallim 14,7 % të grave me arsim të lartë janë të vetë-punësuar pa punëtorë krahasuar me burrat.

Treguesi më shqetësues në tregun e punës është niveli i lartë i grave joaktive, të cilat as nuk janë të punësuar dhe as nuk kërkojnë punë. Sipas anketës së përdorimit të kohës të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), arsyet kryesore të pasivitetit tek gratë (32.2%) është kujdesi për fëmijët, 16% besojnë se nuk ka vende pune në dispozicion, ndërsa 2.2% kujdesen për të moshuarit ose të rritur të tjerë të paaftë.¹⁷ Gratë shpenzojnë 7.2 orë për kujdesin familjar dhe atë shtëpiak krahasuar me 2.5 orë që e shpenzojnë burrat.¹⁸ Hulumtimet e fundit në Kosovë tregojnë se në vitin 2022 gratë shpenzonin 6.2 orë në punë e përkujdesjes pa pagesë në Kosovë, pra 44% më shumë se burrat.¹⁹

Në përgjithësi, tregu i punës përveç jo stabilitetit, tregon se gratë në Kosovë janë kryesisht të përqendruara në arsim, tregti me shumicë dhe pakicë dhe në sektorin e shëndetësisë, ndërsa pothuajse mungojnë në veprimtarinë e patundshmërive, gjë që tregon një treg pune të dominuar thellë nga njëra gjini.

Sipas Bankës Botërore (2017), rritja e cenueshmërisë ekonomike dhe pabarazisë së grave në tregun e punës ndodh për shkak të sasisë së madhe të kohës që gratë shpenzojnë duke u kujdesur për fëmijët dhe anëtarët e familjes.

Korniza ligjore dhe faktorët social

Sa i përket të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, korniza ligjore në Kosovë është në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kushtetuta e vendit shpall dhe garanton të drejtat e grave për të qenë të barabarta me burrat dhe ndalon diskriminimin në bazë të elementit gjinor në të gjitha nivelet e shoqërisë, të institucioneve dhe të aspekteve të jetës në Kosovë. Përveç kësaj, Ligji për Barazinë Gjinore siguron që të drejtat e grave të promovohen dhe mbrohen. I gjithë legjislacioni në Kosovë që lidhet me punësimin është i përafëruar me legjislacionin (acquis) të BE-së, si parakusht për miratimin e tyre.

Megjithatë, Kosova vazhdon të ketë një pjesë të madhe të patriarkalizmit të ngulitur në sjelljen sociale. Shoqëria në të gjitha nivelet, në masë të madhe, nuk ka qasje të ndjeshme gjinore, që d.m.th., se elementët e diskriminimit ndaj grave mund të kalojnë pa u evidentuar, ose të mos “vlerësohen” si të rrezikshëm dhe me efekt.

Një shembull i kësaj qasjeje është rëndësia e Ligjit të Punës dhe dispozitave të tij për pushimin e lehonisë që vazhdojnë të lejojnë një mjedis diskriminues ndaj grave në tregun e punës, veçanërisht në sektorin privat. Sipas Ligjit të Punës, për gjashtë muajt e parë, grave në pushim të lehonisë u paguhet 70% e pagës nga punëdhënësi, dhe 50% e pagës mesatare në Kosovë u paguhet grave në pushim të lehonisë, nëse ato e vazhdojnë pushimin e lehonisë për tre muaj të tjerë, dhe tre muaj të tjerë mund të zgjaten si pushim pa pagesë. Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë për gati një dekadë e kanë vazhduar avokimin e tyre të vazhdueshëm me Qeverinë e Kosovës për t'i ndryshuar këto dispozita dhe për të reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar gjinore, duke përfshirë ndryshimet që do ta akomodonin lejen prindërore, për të nxitur kështu kujdes dhe përgjegjësi të barabarta si për burrat, ashtu edhe për gratë, si dhe t'u krijojnë mundësinë ligjore grave që t'ua bartin pushimin e tyre baballarëve me vendim të tyre.

- Siguroni 8 muaj pushim lehonie për nënat, në të cilat 4 muaj do të mbuloreshin nga punëdhënësi (70% e pagës), 2 muaj nga qeveria (50% e pagës mesatare), dhe me mundësi edhe për 2 muaj shtesë pushim pa pagesë.

- Siguroni lejen e atësisë ku baballarët do të mund të kishin 1 muaj pushim të atësisë me 70% të pagës së tyre të mbuluar nga punëdhënësi, 2 muaj me 50% të pagës mesatare që paguhet nga qeveria, si dhe mundësia edhe për 2 muaj shtesë pushim pa pagesë.²⁰

Ky është një nga modalitetet që do t'u jepte mundësinë nënave për t'u rikthyer shumë më shpejt në tregun e punës dhe do t'i lejonte ato ta balanconin sistemin e punës dhe të jetës, e cila është në respekt edhe të

direktivës së BE-së 2019/1158. Ndërkohë, D4D me OShC-të e tjera që punojnë për të drejtat ekonomike të grave e kanë hartuar një model shtesë paksa të modifikuar të lejes prindërore si një model i përbashkët i lejes prindërore për t'u marrë në konsideratë, i organizuar si leje prindërore (6+3+3), 6 muaj pushim i lehonisë, dhe 1 leja prindërore (e pa transferueshme) që mbulohet nga Qeveria e Kosovës; 3 muaj (2 muaj pushim lehonie dhe 1 leje e atësisë (e pa transferueshme) që paguhet nga punëdhënësi, dhe 3 muaj pushim pa pagesë (2 muaj pushim lehonie dhe 1 muaj leje e atësisë (e pa transferueshme).

Përveç kësaj, ndryshimi i qasjes qeveritare dhe institucionale ndihmon edhe në ndryshimin e faktorëve diskriminues socialë ekzistues që i lidhin të gjitha detyrat dhe obligimet prindërore vetëm me nënat. Ky qëndrim social, përveç diskriminimit afatgjatë të grave dhe shtyrjes së tyre drejt pasivitetit, krijon familje ku baballarët pothuajse mungojnë në jetën e fëmijëve të tyre, duke zbatuar më tej normat patriarkale të detyrave familjare sipas ndarjeve gjinore. Është e rëndësishme veçanërisht të theksohet se ekziston vullneti i burrave/baballarëve për të qenë pjesë e jetës së fëmijëve të tyre, nëse do të jepej dhe do të mbulohej financiarisht kjo mundësi. Sipas një ankete të kryer nga D4D në vitin 2021, 30.5% e burrave u përgjigjën se do ta shfrytëzonin lejen prindërore, nëse kjo do të paguhej plotësisht, dhe 19.4% u përgjigjën se do ta shfrytëzonin lejen e tyre të atësisë edhe nëse kjo do të paguhej vetëm pjesërisht.²¹

Të dhënat nga hulumtimet e ndryshme të kryera ndër vite në Kosovë, dhe veçanërisht nga D4D (hulumtimi i kryer nga D4D në vitin 2017) kanë treguar se shumica e të anketuarve (60%), konsiderojnë se gratë janë të diskriminuara në procesin e rekrutimit dhe konsiderojnë se shoqëria patriarkale (40%) dhe pushimi i papërshtatshëm i lehonisë (26%) janë arsyet për një gjë të tillë. Puna e papaguar e grave dhe përgjegjësitë e tyre për t'u kujdesur për fëmijët dhe të moshuarit janë arsye kryesore të mungesës së grave në tregun e punës.²²

Edhe pse Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-02 i Republikës së Kosovës i obligon të gjitha institucionet të miratojnë strategji dhe plane veprimi që promovojnë barazinë gjinore sipas Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, të sigurojnë integrimin gjinor të të gjitha politikave dhe legjisllacionit, të garantojnë buxhetimin gjinor dhe të ndajnë burimet e nevojshme për nismat që e avancojnë barazinë gjinore, Strategjia Sektoriale 2018-2022 e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale nuk kishte qasje ndër-sektoriale. Strategjia e re e Punësimit e Ministrisë aktuale të Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës ende nuk ka arritur të nxjerrë një strategji të re punësimi që do t'i adresonte zbrastësitë aktuale dhe do të kishte një efekt më të madh në tregun e punës sa i përket punësimit të grave.

Analiza e të dhënave të anketës

Në anketën e kryer nga D4D në mars/prill 2023 përmes pyetësorëve online të shpërndarë përmes Google Forms, u morën gjithsej 111 përgjigje. Kjo anketë kishte për qëllim të ofrojë një pasqyrë të shpejtë të punës së papaguar të grave në Kosovë. Përmes 10 pyetjeve, në anketë u shtrua pyetje për të anketuarit sa përket statusit të tyre të punësimit, nëse të anketuarit e papunë po kërkonin punë dhe pse, cilin aktivitet familjar e kryenin më shumë, kush mendojnë ata/ato se duhet t'i kryejë punët e shtëpisë, kush kujdeset (duhet të kujdeset) për fëmijët, dhe në kryerjen e cilave aktivitete shpenzojnë më shumë kohë gjatë ditës.

Në anketë, 79.2% e të anketuarve ishin gra, ndërsa 20.7% burra. 70% e të anketuarve jetonin në zonat urbane dhe 30% e tyre në zonat rurale. 24.3% e të anketuarve ishin të moshës 15-24 vjeç, 38.7% ose shumica mes 25-32 vjeç, 23.4% mes 33-45; 12.6% mes 46 dhe 54 vjeç dhe vetëm 1.8% mes moshës 54-65 vjeç.


Nga 111 të anketuar, 68% ishin të punësuar në sektorin privat, 2,7% në sektorin publik, 26,1% të papunë, ndërsa vetëm 3,6% ishin të papunë dhe në kërkim aktiv të punës. Në pyetjen si vijon se pse të anketuarit e papunë nuk po kërkonin punë, 50% deklaruan se kishte punë por me paga të ulëta, 22.5% thanë se nuk kishte punë, ndërsa 10% deklaruan se nuk kanë kohë për të punuar për shkak të punëve të shtëpisë, kujdesit për fëmijët ose kujdesit për të moshuarit. Ndërkohë, 15% e të anketuarve, e cekën mungesën e transportit si arsye se pse nuk mund të punojnë.

Në pyetjen “Me cilat punë të shtëpisë merreni më shumë” shumica e grave (47%) e renditën pastrimin si punët e tyre të shtëpisë që kryejnë më së shumti, e pasuar nga gatimi dhe kujdesi për fëmijët (21.3%), kujdesi për të moshuarit (4.5%) dhe vetëm 4.5% e grave deklaruan se nuk bëjnë asnjë nga punët e shtëpisë.


Krahasuar me gratë, shumica e të anketuarve burra (39.1%) deklaruan se nuk bënin asnjë nga punët e shtëpisë, ndërsa 34.7 e renditën kujdesin për fëmijët si një veprimtari që kryejnë më së shumti, ndërsa asnjë nga të anketuarit burra nuk kujdesej për të moshuarit si pjesë e veprimtarisë së tyre në shtëpi.

“Mund të bënim shumë gjëra, mund të ndryshonim kombin, por nuk kemi kohë. Jemi shumë të zënë me punët e shtëpisë”


citat nga Fokus Grupi



Grafika 1. Me cilat punë të shtëpisë merreni më shumë?




Grafiku 2. Kush duhet të merret me punët e shtëpisë?



Ndërkaq, në pyetjen "Kush duhet të merret me punët e shtëpisë", asnjë nga të anketuarit burra apo gra nuk mendonin se burrat duhet të bëjnë ndonjë nga punët e shtëpisë. 21.7% e burrave mendojnë se gratë duhet t'i kryejnë punët e shtëpisë dhe 2.3% e grave pajtohen me këtë përgjigje. Ndërkohë, 97.7% e grave dhe 82.6% e burrave konsiderojnë se gratë dhe burrat duhet të jenë përgjegjës në mënyrë të barabartë.

Grafiku 3. Kush kujdeset (apo duhet të kujdeset) për fëmijët?



Sa i përket përgjegjësisë së ndarë sipas gjinisë në familje (kush duhet të kujdeset për fëmijët), as gratë e anketuara dhe as ata burra, nuk u përgjigjen se kujdesi për fëmijët është përgjegjësi e baballarëve. Ndërkohë, 21.7% e burrave u përgjigjen se gratë duhet të kujdesen për fëmijët, ndërsa 9% e grave të anketuara ndajnë të njëjtin mendim. Ndërkohë, 89.7% e grave dhe 78.2% e burrave besojnë se përgjegjësia e kujdesit ndaj fëmijëve duhet të jetë e barabartë si për nënat, ashtu edhe për baballarët.

Gratë i kuptojnë ndryshe të drejtat e tyre

Edukimi i grave për të drejtat e tyre duhet të shkojë paralelisht me edukimin e burrave për të drejtat e grave

Koncepti i pavarësisë së gruas kuptohet ndryshe nga gratë


Në familje ka respekt më të madh ndaj grave sapo ato fillojnë të punojnë

Ekonomia e kujdesit është ekonomia e nënshtrimit të grave

Gratë janë paragjyqese ndaj vetvetes;

Gratë nuk e gëzojnë respektin e të tjerëve kur ato nuk respektojnë veten

Pas një gruaje të suksesshme qëndron një burrë i mirë



Përfundime

Barazia gjinore si koncept dhe çështje praktike vazhdon të përballet me pengesa dhe sfida në Kosovë, si në nivel shoqëror, ashtu edhe në atë institucional. Ndërkohë që shoqëria vazhdon t'i praktikojë dhe vlerësojë normat patriarkale si vlera të rëndësishme identifikuese shoqërore, pozita e gruas në familje, shoqëri dhe sidomos në tregun e punës vazhdon të jetë e pafavorshme. Ndërkaq, infrastruktura ligjore në Kosovë sa i përket barazisë gjinore është mjaft e kompletuar, veprimet dhe masat për zbatimin e saj në praktikë janë mjaft të pakta, që reflektohet me pjesëmarrjen e ulët të grave në tregun e punës, numrin e lartë të grave joaktive në atë treg dhe përqindjen e ulët të grave të punësuar. Ndonëse më shumë se 80% e grave në moshë pune janë joaktive, hulumtimi ka treguar se një pjesë e madhe e tyre çdo ditë kryejnë punë të papaguara, kryesisht në kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve.

Është e rëndësishme të vihet në dukje, jo vetëm për këtë hulumtim, por për ta trajtuar punën e papaguar si qasje diskriminuese ndaj grave, se ideja parësore e trajtimit të të gjitha aspekteve të punës së papaguar, nuk është të deklarohet kujdesi për fëmijët ose kujdesi për familjen si detyra të padëshirueshme, por më tepër adresimi i çështjes së punës sipas perspektivës gjinore e cila vazhdon të zbatohet dhe riprodhojë normat patriarkale në shoqëri, si dhe qasjen institucionale ndaj punës së kryer kryesisht nga gratë si e pavlerësuar dhe e pa llogaritur si kontribut në ekonominë e shtetit. Kështu, nëse puna e papaguar e grave dhe ekonomia e kujdesit nuk matet në të gjitha aspektet, ajo do të mbetet e padukshme. Ndërkohë, siç ka treguar edhe situata e pandemisë COVID-19, puna e kujdesit e papaguar, ashtu sikurse puna me pagesë janë shtylla të rëndësishme të ekonomisë, e që janë të rëndësishme për funksionimin e duhur të saj, dhe pa ndonjërin prej tyre, shoqëria nuk do të mund ta mbante veten.

Rekomandime

Ekonomia e kujdesit në Kosovë dominohet nga gratë, por jo se ato e kanë zgjedhur këtë. Gjersa brezat e grave i rijetojnë detyrat e imponuara gjinore nga familja, shoqëria dhe komuniteti, si dhe mungesa e veprimeve institucionale për të ndryshuar rrjedhën e riprodhimit patriarkal kjo paraqet një tregues i dyfishtë: mungesën e strategjisë së duhur për të ndryshuar jetën e grave dhe t'u ofrojë atyre alternativa, si dhe mungesën e interesit për të sjellë një zgjidhje për gratë dhe shoqërinë.

Ky hulumtim, përmes fakteve dhe shifrave, ka analizuar shkurtimisht çështjen e ekonomisë së kujdesit, me synimin që të sjellë rekomandime për të gjithë akterët e shoqërisë, përfshirë gratë, burrat, familjet, shoqërinë dhe institucionet, që janë bashkëpjesëmarrës dhe bashkë-përfitues. në ri-drejtimin e ekonomisë së kujdesit.

- Politikat e punësimit në Kosovë duhet t'i përgjigjen situatës së tregut të punës. Gratë vazhdojnë të mungojnë kryesisht në tregun e punës, një situatë që ka dominuar për më shumë se një dekadë. Duhet të ofrohen politika të duhura punësimi dhe mundësi punësimi për gratë, që i përgjigjen nivelit të arsimimit, aftësive, vendbanimit, etj.

- Ligji i Punës i Republikës së Kosovës nuk përkon me mjedisin patriarkal në Kosovë. Një nga katër pengesat kryesore të identifikuar për pasivitetin e grave është paaftësia e tyre për t'u rikthyer në tregun e punës për shkak të modelit të papërshtatshëm të pushimit të lehonisë që ofrohet në Ligjin e Punës. Gjersa gratë e kanë të drejtën e pushimit të lehonisë 1-vjeçare (të pa transferueshme) me model (6 muaj të paguar nga punëdhënësi (70%), 3 muaj nga qeveria (50% e pagës mesatare), dhe 3 muaj pushim pa pagesë), leja e atësisë përcaktohet në 2 ditë. Ky model i pandryshuar në 13 vitet e fundit, e përçon mesazhin e neglizhencës institucionale ndaj barrës së rëndë të kujdesit që kanë gratë, por edhe të krijimit të familjeve ku nënat dhe baballarët nuk janë në mënyrë të barabartë pjesëmarrës në jetën e fëmijës. Andaj rekomandojmë që të merret parasysh modeli i përbashkët i lejes prindërore, e organizuar si pushim prindëror (6+3+3), 6 muaj pushim të lehonisë dhe 1 pushim prindëror (i pa transferueshëm) që mbulohet nga Qeveria e Kosovës; 3 muaj (2 muaj pushim i lehonisë dhe 1 leje atësie (e pa transferueshme) që paguhet nga punëdhënësi, dhe 3 muaj pushim pa pagesë (2 muaj pushim lehonie dhe 1 muaj leje atësie (e pa transferueshme).

- Adresoni çështje specifike që lidhen me barrierat sociale dhe kulturore sa i përket pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, duke hapur qendra të përbalueshme të kujdesit ditor, shtëpi për të moshuarit dhe transport të përbalueshëm dhe të shpeshtë për t'iu mundësuar grave nga zonat rurale të kenë qasje të barabartë në mundësitë për punë, përforcojeni zbatimin e ligjit duke vënë në zbatim institucionet dhe mekanizmat monitorues;

- Nga institucionet përgjegjëse shtetërore duhet të kryhet një vlerësim kombëtar i anketës për pjesëmarrjen e grave në ekonominë jo formale;

- Paga e barabartë për punë të barabartë. Duke qenë se hulumtimet dhe praktika kanë treguar se gratë me formim profesional dhe kualifikime të njëjta, për të njëjtin lloj dhe sasi pune, paguhen afërsisht 6% më pak se burrat, fuqimisht rekomandohet që të ndërmerret çdo mjet i nevojshëm për eliminimin e këtij fenomeni. Hendeku gjinor i pagave është formë klasike e diskriminimit, prandaj kërkohen veprime institucionale për të adresuar dhe eliminuar një pengesë ngulfatëse për barazinë e grave në tregun e punës dhe në shoqëri.

Albania

Hyrja

Ndonëse Shqipëria renditet ndër vendet e para në rajon për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës (RCC, 2022), pabarazitë gjinore vazhdojnë të jenë pranishme dhe mbizotëruese në shoqërinë shqiptare. Raporti i fundit Burra dhe Gra, i publikuar nga INSTAT-i tregon se shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç ishte 68,2% për burrat dhe 53,8% për gratë në vitin 2021. Ndërkohë që shkalla e punësimit u kthye në nivelin e vitit 2019 për burrat, ajo vazhdoi të jetë pak më e ulët për gratë krahasuar me vitin 2019.²³ Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për burrat në vitin 2021 ishte 77.3 krahasuar me 61.4% për gratë, një dallim prej 15.9%, krahasuar me një dallim prej 14.4% për shkallën e punësimit. Struktura e të punësuarve tregon se 43,3 % e grave në fuqinë punëtore janë të punësuarat në pozita me pagesë, ndërsa 22,8 % e tyre angazhohen në punë pa pagesë në biznesin familjar. Për burrat e punësuar, këto shifra janë përkatësisht 41,6 % dhe 13,1 %. Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme e burrave - përkatësisht 33,3 % në fuqinë punëtore janë të vetëpunësuar, krahasuar me 21,5 % të grave.²⁴ Sipas shkaqeve të pasivitetit, në përgjithësi, gratë mbeten jashtë fuqisë punëtore kryesisht për shkak se janë të zëna me punë të papaguara në shtëpi (18,8 %), ose për shkak se e vijojnë shkollën (20,9 %). Nga ana tjetër, vetëm 0,6 % e burrave deklarojnë se janë punët e shtëpisë si arsye e joaktivitetit të tyre, ndërsa 25,7 % janë studentë ose nxënës.²⁵

Recesioni në hije të pandemisë COVID-19 shpesh është etiketuar si “recesion i grave”, që nënkupton efekte ekonomike disproporcionalisht negative për gratë, krahasuar me burrat. Hendeqet gjinore ndryshojnë në vende të ndryshme, por, mesatarisht, vlerësimet ndërkombëtare të OECD-së dhe ato globale tregojnë se orët e punës së grave dhe shkalla e punësimit të grave ranë me ritëm më të madh se sa i burrave në muajt e parë të pandemisë.²⁶ Ndonëse të dhënat nga Shqipëria treguan se pak më shumë burra se gra u ndikuan nga humbja e vendeve të punës, gratë u ndikuan në mënyrë disproporcionale nga humbja e të ardhurave, sidomos ato të vetë-punësuarat. Për më tepër,²⁷ te gratë u vërejt një rritje të kohës së shpenzuar për punë të papaguara dhe në ato të përkujdesjes me një dallim prej 10% krahasuar me burrat.

Shqipëria është shumë e vonuar sa i përket kryerjes së Anketës së përdorimit të kohës. E fundit ishte kryer në vitin 2011 dhe është e vetmja pikë referimi për t'i kuptuar përmasat e punës së papaguar të kujdesit në vend. APK e 2011 tregon se gratë shqiptare (të moshës 15-64 vjeç) shpenzonin 2 orë e 20 minuta për punë me pagesë dhe 5 orë e 46 minuta në ditë për punë të ndryshme pa pagesë. Pjesa më e madhe e punës së papaguar janë punë të shtëpisë (përgatitja e ushqimit, pastrimi, larja e rrobave, etj.) por ato përfshijnë edhe kujdesin për fëmijët (47 minuta) dhe kujdesin për të rriturit (5 minuta).

Nga ana tjetër, burrat shqiptarë shpenzuan 5 orë e 12 minuta për punë me pagesë, dhe vetëm 48 minuta për punë pa pagesë në ditë, duke përfshirë 3 minuta për kujdesin ndaj fëmijëve dhe 1 minutë për kujdesin ndaj të rriturve.²⁸ Sipas një studimi më të fundit të kryer nga UN Women dhe UNICEF në vitin 2022, “proporcioni i punës së papaguar në ditë është 21,74 përqind për gratë dhe vetëm 3,47 përqind për burrat, që do të thotë se gratë bëjnë gati një të katërtën e punës së tyre, qoftë ajo në shtëpi ose në vendin e punës, falas. Gratë shqiptare shpenzojnë 21.74 përqind të ditës së tyre duke bërë punë pa pagesë, duke përfshirë gatimin, pastrimin dhe kujdesin për fëmijët dhe anëtarët e familjes. Kjo ka efekte të rëndësishme financiare dhe ekonomike për gratë dhe shoqërinë në përgjithësi.”²⁹ Disa vlerësime e vendosin vlerën e punës së papaguar të grave në 7.2% krahasuar me 1.2% të PBB-së për punën e papaguar të burrave.³⁰ Gratë zënë 85.8% të totalit të punës së papaguar. Puna e papaguar përbën afërsisht 60% të PBB-së në Shqipëri.⁸ Vlera e kësaj pune është 84 dollarë amerikanë (71 euro) bazuar në pagën mesatare mujore prej 390 dollarësh amerikanë (330 euro), dhe duke pasur parasysh se 35% e rreth 1.08 milionë grave në Shqipëri janë të punësuar, kjo është baras me atë se ekonomia shqiptare humb një potencial prej 32 milionë dollarë (27 milionë euro) çdo muaj dhe 385 milionë dollarë (324 milionë euro) në vit.³¹

Gratë në sektorin publik dhe atë privat

Ekzistojnë boshllëqe të konsiderueshme gjinore në sektorin ekonomik, që rrjedhin kryesisht nga pjesëmarrja e ulët e grave në fuqinë punëtore, nivelet e larta të informalitetit, ndarja gjinore e punës dhe qasja e ulët në inputet e produkteve. Stereotipet profesionale i kufizojnë zgjedhjet e grave, me gratë që punojnë kryesisht në sektorë të tillë si shëndetësia dhe puna sociale, arsimiti, prodhimi dhe bujqësia, që karakterizohen me paga më të ulëta. Bujqësia mbetet sektori primar që punëson gra, me 41.6 përqind të grave krahasuar me 32.3 përqind të burrave.³² Ndonëse gratë mund të besojnë se ato janë të përfshira në aspektin shoqëror dhe kulturor, ekziston prirja që prona ligjrisht të mos jetë në emrin e tyre. Në veçanti, statusi i pronësisë së grave mbi tokën bujqësore është përkeqësuar: vetëm 14 përqind e grave deklarojnë se kanë pronësi mbi tokën bujqësore, që është gjysma e shkallës së deklaruar nga burrat (28 përqind).³³

Sfida të tjera që ndikojnë tek gratë në bujqësi përfshijnë një nivel të lartë të punësimit jo formal, ku një raport i FAO-s i vitit 2016 vuri në dukje se vetëm 19% e grave nga zonat rurale kishin marrë pushim të lehonisë, krahasuar me 59% të homologeve të tyre nga zonat urbane. Përveç kësaj, shërbimet e kujdesit për fëmijët praktikisht mungojnë në shumë zona rurale, duke rritur kështu barrën e kujdesit dhe ngarkesën e punës së grave dhe duke kontribuar në forcimin e stereotipit që bazohet në gjini të aktiviteteve të ripërsëritura si “thjesht një rol i gruas”.

Së fundi, në bujqësinë familjare, ka një shpërndarje të ngurtë të detyrave të bazuara në gjini. Rolet gjinore të burrave përcillen me detyra që përfshijnë kontrollin mbi asetet bujqësore, lëvizshmërinë dhe vendim-marrjen, ndërsa rolet gjinore të grave lidhen me punën që kryhet me dorë në bujqësi dhe blegtori, përfshirë aktivitetet para korrjes dhe pas korrjes, përpunimin e ushqimit dhe punët e ekonomisë familjare. Kjo shpërndarje e punës ka rezultuar në qasjen dhe kontrollin e kufizuar të grave mbi asetet bujqësore dhe vendim-marrjen.³⁴

Në vitin 2019, punësimi jo formal në Shqipëri si % e punësimit të përgjithshëm jo-bujqësor ishte 35,6 përqind për burrat dhe 21,8 përqind për gratë, duke treguar një ulje prej 4,8 përqind për burrat, por vetëm 2,2 përqind për gratë që nga viti 2015. Kur punësimi jo formal në bujqësi duke përfshirë faktin se shkalla e informalitetit në Shqipëri është 61.0 përqind, që përfaqëson më shumë se gjysmën e popullsisë së punësuar.³⁵ Kur vlerësohet punësimi joformal, pjesëmarrja e grave është më e lartë në sektorin e bujqësisë dhe në kategorinë e punëtorëve të papaguar në familje, ndërsa burrat dominojnë në punësimin jo formal në sektorët jo-bujqësor. Pavarësisht rëndësisë së saj, kjo punë vazhdon të mos duket dhe të nënvlerësohet dhe të shpërfilllet kur bëhet fjalë për hartimin e politikave makroekonomike dhe sociale. Përveç feminizimit të punës së papaguar të kujdesit, gratë mbi-përfaqësohen në fushën e punës së kujdesit me pagesë që rëndom karakterizohet nga paga të ulëta dhe kushte të paqëndrueshme.

Një studim i vitit 2010 doli me vlerësim të përafërt se ekonomia jo formale e vendit ishte e barabartë me 32.9 përqind të PBB-së së saj. Hulumtime të tjera kanë zbuluar se 40 përqind e punëtorëve kanë pranuar se janë të detyruar të konkurrojnë me sektorin jo formal. Akoma më alarmante, Qeveria shqiptare konfirmoi në vitin 2015 se ekonomia jo formale përbën 50 përqind të PBB-së. Punësimi joformal merr forma të ndryshme. Për shembull, 39.75 përqind e të punësuarve deklaruan se nuk kishin kontratë me shkrim me punëdhënësin e tyre, ndërsa 30.29 përqind deklaruan se nuk i paguanin përfitimet për sigurimet shoqërore dhe ato shëndetësore.³⁶

Faktorët ligjorë dhe social

Që nga rënia e komunizmit, Shqipëria ka ndërmarrë hapa vendimtarë drejt barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Kuadri ligjor është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat e të drejtave të njeriut. Ekziston një ligj për barazinë gjinore që nga viti 2008, një ligj për mbrojtjen nga diskriminimi që nga viti 2010 dhe një ligj për luftimin e dhunës në familje që nga viti 2006, e të gjitha këto ligje kanë pësuar rishikime të rëndësishme që nga miratimi i tyre fillestar. Siç theksohet në Raportin e BE-së për vitin 2022, "Shqipëria në përgjithësi vepron në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore. Gjatë periudhës së raportimit, është bërë njëfarë progresi, veçanërisht me miratimin e një plani kombëtar të ri veprimi me buxhetim më të mirë për personat LGBTIQ, një strategji kombëtare për barazinë gjinore dhe një plan kombëtar veprimi për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri".³⁷

SKBGJ 2021-2030 përmban një objektiv specifik për të adresuar punën e papaguar të shtëpisë dhe të kujdesit. Objektivi 1.1 thotë "Zbatimi i kuadrit ligjor dhe politikave të përmirësuara, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve".³⁸ Pavarësisht këtyre dispozitave dhe përmirësimeve të përgjithshme në kuadrin ligjor për barazinë gjinore në Shqipëri, sfidat mbeten në trajtimin efektiv të shpërndarjes së pabarabartë të barrës ndërmjet burrave dhe grave në fushën e ekonomisë së kujdesit.

Sfidat rreth kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi në Shqipëri lidhen qenësisht me faktorët socialë, qëndrimet shoqërore dhe traditat, të manifestuara në formën e roleve të ngurta gjinore, ku gratë duhet të jenë kuj-

destaret në shtëpi, ndërsa burrat duhet të ofrojnë siguri financiare për familjen. Në një artikull të kohëve të fundit ku analizohej koncepti i “nuses së shtëpisë”, Jaso argumenton se ky ligjërimit “mbështetet nga konsideratat morale të asaj se çfarë duhet të jetë një grua shqiptare: “nusja e shtëpisë” është gjithmonë e bindur, e mban shtëpinë të pastër pa u ankuar dhe bën të gjitha gatimet. Ajo gjithmonë vendos nevojat e burrit të saj (dhe të vjehërve) para të sajave dhe është një nënë e përkushtuar që rrit fëmijë të mirë (mundësisht djem). Këto rrëfime zhvillohen brenda kontekstit të njësisë tradicionale të familjes shqiptare. Larg nga të qenit relike e së shkuarës, idioma “nusja e shtëpisë” formon dhe riprodhon marrëdhëniet gjinore-shtypëse në shoqërinë shqiptare sot, duke diktuar sjelljen morale të shumë grave shqiptare brenda dhe jashtë sferës private.³⁹

Në përputhje me këtë, gratë preken në mënyrë disproporcionale nga përgjegjësitë e kujdesit për fëmijët dhe kujdesit afatgjatë për të moshuarit, gjë që u ngarkon atyre një barrë të rëndë, pavarësisht nga statusi i punësimit. Prandaj, gratë në Shqipëri kanë nevojë për kujdes të përbalueshëm për fëmijët, për të qenë në gjendje të ndjekin mundësi të mira pune dhe të rrisin qëndrueshmërinë ekonomike, barazinë dhe sigurinë e tyre. Megjithatë, shpenzimet për shërbimet e kujdesit social janë relativisht të ulëta (në 3% të programit të përgjithshëm buxhetor të mbrojtjes sociale). Reduktimi i kujdesit të hershëm të fëmijës dhe mungesa e strukturave të shërbimeve sociale të krijuara për të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara, ka çuar në një rritje të numrit të grave në moshë pune në punët e kujdesit pa pagesë, të cilat mbeten jashtë tregut të punës për shkak të përgjegjësisë të tyre në punët e shtëpisë për fëmijët ose të moshuarit ose për personat me aftësi të kufizuara. Zhvillimi i politikave dhe i programeve që vendosin kujdesin universal për fëmijët, ose mbrojtjen sociale për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, do të mundësonte pjesëmarrjen e grave në aktivitetet e punësimit me pagesë dhe do të zvogëlonte varfërinë, duke rritur nivelin ekonomik të familjes.⁴⁰

Pavarësisht njëfarë progresi në domenin e politikave dhe atë ligjor për avancimin e barazisë gjinore, në përgjithësi ka një hendek në politikat që lidhen me ndarjen e barabartë të kohës dhe të përgjegjësisë shtëpiake ndërmjet burrave dhe grave. Nismat kryesore për një mënyrë jetese më të ekuilibruar dhe lehtësimin e grave nga përgjegjësitë e tyre të rritjes dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve, janë ndërmarrë në ndryshimet në kuadrin ligjor. Në këtë drejtim, një rishikim i Ligjit për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i datës 11.05.1993 dhe i ndryshuar më 9.03.2017, ka njohur të drejtën e baballarëve për të marrë pushimin e atësisë pas 63 ditësh periudhë pushimi të detyrueshëm për nënat. Ndryshimet në kodin e punës po ashtu i lejojnë secilit prej prindërve të kërkojë leje prindërore. Më tej, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka filluar me nismën “T”i bëjmë detyrat e shtëpisë”, ku nxënësit qëndrojnë në shkollë edhe për dy orë të tjera pas përfundimit të periudhës së mësimt shkollor, për t’i kryer detyrat e shtëpisë dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore. Kjo nismë u krijua për të ofruar mjedis të barabartë për fëmijët me prejardhje të ndryshme social-ekonomike, që t’i kryejnë detyrat e shtëpisë dhe t’i rrisin arritjet arsimore të tyre. Për më tepër, kjo u siguron nënave dhe familjeve kujdes shtesë për fëmijët, duke krijuar kështu një mjedis më të favorshëm për nënat në tregun e punës. Së fundi, rishikimet në “Kodin e Punës” të Shqipërisë kanë përfshirë dispozita për aranzhime më fleksibile të punës, për të përfshirë punën në distancë dhe punën nga shtëpia. Me Ligj kërkohej që për këtë lloj pune të ketë të drejta dhe kushte pune të njëjta sikurse lloji i njëjtë i punës që kryhet nga punonjësit e tjerë.⁴¹


Shqipëria ende ka nevojë në shërbimet e kujdesit afatgjatë për të moshuarit, që kufizohet nga të ardhurat e ulëta të familjeve dhe të moshuarve, si dhe nga kapacitetet e kufizuara financiare të buxhetit publik

dhe skemave të sigurimeve shoqërore.⁴² Rritja e qasjes në kujdesin cilësor të fëmijëve, mund të ketë efekte në shumë breza, me ç'rast do të përmirësohej punësimi dhe produktiviteti i grave, rezultatet e fëmijëve, mirëqenies së familjes, produktiviteti i biznesit dhe ekonomia në tërësi. Pavarësisht dëshmimeve të konsiderueshme që tregojnë përfitimet e kujdesit ndaj fëmijëve për barazinë ekonomike të grave, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e fëmijëve, shumë qeveri dështojnë ta njohin dhe pranojnë kujdesin ndaj fëmijëve si një e mirë publike dhe ta garantojnë atë në mënyrë adekuate. Prindërit kanë mbetur në vështirësi për të menaxhuar me kujdesin ndaj fëmijëve, miliona gra mbahen jashtë fuqisë punëtore dhe gjysma e fëmijëve në botë nuk kanë arsim para fillor. Një studim rajonal i kohëve të fundit mbi kujdesin afatgjatë në Ballkanin Perëndimor tregoi se shumica e të anketuarve mendonin se disa nga barrierat më të rëndësishme sa i përket kujdesit, janë për shkak të kostos (40%) dhe qasjes dhe disponueshmërisë (27%).⁴³

Gjetjet e anketave

Për t'i përplotësuar të dhënat e mbledhura përmes rishikimit të literaturës, në qershor 2023 u shpërnda një anketë në internet, përmes platformave të mediave sociale, e hapur për një periudhë prej 10 ditësh. Gjithsej 90 të anketuar përfunduan anketën, ajo ishte ideuar për t'i kuptuar më mirë perceptimet mbi përgjegjësitë e kujdesit pa pagesë brenda shtëpisë dhe se si burrat dhe gratë e kalojnë ditën e tyre *kundrejt* përgjegjësisë të kujdesit. Grafikët si vijon paraqesin një përmbledhje të gjetjeve nga përgjigjet e anketës, si dhe ofrojnë një përshkrim të vogël të momentit se si burrat dhe gratë i shohin rolet e tyre brenda shtëpisë.


Kush duhet të bëjë punët e shtëpisë?



Grafiku 4. Ndarja e punëve të shtëpisë

Të pyetur se kush duhet të jetë përgjegjës për punët e shtëpisë, shumica dërrmuese e grave (97%) janë përgjigjur se si gratë, ashtu edhe burrat duhet të ndajnë këto përgjegjësi. Kjo përqindje është më e ulët në mesin e burrave që iu përgjigjën anketës, megjithatë, është inkurajuese se gati 4 në 5 burra thanë se të dyja gjinitë duhet t'i ndajnë punët e shtëpisë dhe përgjegjësitë e shtëpisë, ndërsa 23% thanë se gratë duhet të kujdesen për to.


Ndarja e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët



Grafiku 5. Ndarja e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët

Të pyetur se kush duhet të jetë përgjegjës për kujdesin ndaj fëmijëve, ekziston një dallim i vogël mes të anketuarve gra dhe atyre burra. Anketa tregon se asnjë nga burrat e anketuar nuk i përzgjedhi baballarët si kujdestarët kryesorë për fëmijët, ndërsa 15% e tyre mendonin se nënat duhet të ishin kujdestaret e vetme. Nga ana tjetër, anketa po ashtu tregon se më shumë gra thanë se nënat duhet të kujdesen për fëmijët, krahasuar me gratë që thanë se baballarët duhet të jenë përgjegjës (6% krahasuar me 1%). Shumica dërrmuese e grave (92%) dhe e burrave (85%) mendojnë se kjo duhet të jetë një përgjegjësi e përbashkët mes të dy prindërve.

Grafiku 6. Aktivitetet kryesore të përditshme



Të pyetur se si e kalojnë pjesën më të madhe të ditës, 62% e burrave dhe 58% e grave raportuan se pjesën më të madhe të kohës e kalonin në punë me pagesë. Për më tepër, një përqindje e vogël, dyfish më shumë burra se gra, raportuan se pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në aktivitete të kohës së lirë gjatë ditës së tyre (8% krahasuar me 4%). Asnjë nga burrat e anketuar nuk raportoi se bënte ndonjë gatim ose se blinte gjëra ushqimore si punën e tyre kryesore, ndërsa gratë raportuan në shkallë më të lartë se kalojnë kohë duke u kujdesur për fëmijët dhe duke i larë enët.

Përfundime dhe rekomandime

Gjetjet e anketës më lart tregojnë se gratë vazhdojnë të jenë të mbi-përfaqësuara në ekonominë e kujdesit, ato mbajnë pjesën më të madhe të barrës së kujdesit në shtëpi dhe të përgjegjësive të tjera shtëpiake për shkak të normave sociale dhe kulturore të rolit të grave dhe të burrave. Ndonëse duket se ka një progres të lehtë në të kuptuarit se punët e shtëpisë duhet të ndahen në mënyrë të barabartë për gratë dhe burrat, në përgjithësi më shumë gra thanë se nënat duhet të kujdesen për fëmijët, krahasuar me gratë që thanë se baballarët duhet të jenë përgjegjës. Më tej, asnjë nga burrat e anketuar nuk raportoi se bënte ndonjë gatim ose blerje të ushqimeve si aktivitetin e tyre kryesor, ndërsa gratë raportuan në shkallë më të lartë se shpenzojnë kohë duke u kujdesur për fëmijët dhe duke i larë enët. Edhe pse ka njëfarë progresi sa i përket politikave dhe legjislacionit kombëtar në adresimin e kësaj sfide, kërkohet të bëhet më shumë për t'u ofruar grave realisht mundësitë që të marrin pjesë plotësisht në ekonomi dhe për t'i fuqizuar ato ekonomikisht. Shërbimet sociale nuk po bëjnë mjaftueshëm për të ofruar mbështetjen e nevojshme për të lehtësuar barrën e kujdesit të grave dhe normat tradicionale gjinore vazhdojnë të dominojnë në shoqërinë shqiptare. Më poshtë jepen një sërë rekomandimesh për adresimin e normave sociale dhe politikave të nevojshme në veprim.

Mbrojtja sociale:

- Rritni investimet në sistemet e kujdesit për fëmijët për të adresuar përgjegjësinë disproporcionale të kujdesit që bie mbi gratë. Duhet të ketë një sistem universal të kujdesit për fëmijët që të jetë i përballueshëm dhe i qasshëm për të gjithë, përfshirë edhe zonat rurale.
- Futni në zbatim legjislacionin për të mbrojtur të drejtat e punës/kujdestarëve të papaguar dhe për të siguruar një pagë jetese për punonjësit e kujdesit me pagesë, për të siguruar që ata të kenë qasje në asistencë sociale ose një pagë për jetesë dhe të punohet drejt eliminimit të boshllëqeve gjinore në paga.
- Forconi sistemet e mbrojtjes sociale për të përmirësuar qasjen në kujdesin ndaj fëmijëve dhe mbështetjen jashtë shkollës.
- Njihni dhe pranoni punën e kujdesit me pagesë dhe pa pagesë në nivelin kombëtar të politikave dhe të ligjeve.
- Përmirësoni mbledhjen e të dhënave për punën pa pagesë, për të ndihmuar në informimin dhe formësimin e politikave dhe të vendim-marrjes.
- Kryeni monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, për t'i kuptuar efektet e ndërhyrjeve, dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme.

- Ndërmerrni analiza dhe vlerësim gjinor për t'i marrë në konsideratë efektet e investimeve në infrastrukturë, mbrojtje sociale dhe shërbime publike në punën e papaguar të grave dhe të vajzave dhe nëse këto çojnë në transferimin e përgjegjësive të punës së papaguar te gratë e tjera në familje, veçanërisht tek gratë e moshuara dhe vajzat.
- Siguroni shërbime publike të qasshme dhe të përballueshme për kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, për t'i zvogëluar përgjegjësitë e punës së papaguar të grave, si dhe për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në fuqinë punëtore.

Masat e punësimit:

- Avokoni për politikat e punësimit që mbështesin punonjësit që i ndajnë përgjegjësitë e kujdesit.
- Përmirësoni ndërgjegjësimin për përfitimet e politikave fleksibile të familjes/punës, duke përfshirë oraret fleksibile dhe lloje të ndryshme të aranzhimeve të punës (p.sh. me kohë të pjesshme, orë të reduktuara, orare fleksibile, javë më të shkurtra pune) që do ta lehtësonin shpërndarjen më të barabartë të punës së papaguar dhe që do t'i ndihmonin gratë dhe burrat të gjejnë një ekuilibër më të mirë punë-jetë.
- Rritni dhe forconi ndërgjegjësimin e punëdhënësve për përgjegjësitë e tyre, për të ndihmuar në sfidimin e normave kulturore gjinore dhe të pritshmërive për punëtorë idealë dhe kujdestarë idealë.
- Luftoni informalitetin në tregun e punës, veçanërisht në sektorin e bujqësisë.
- Përmirësoni pozitën e grave në sektorin e bujqësisë, veçanërisht përmes pronësisë mbi pronat dhe shërbimeve sociale për të lehtësuar barrën e tyre për shkak të kujdesit.
- Mbështetni transicionin e kujdestarëve pa pagesë dhe jo formalë në tregun formal të punës.

Ndryshimi i normave shoqërore:

- Ndërmerrni nisma për rritjen e ndërgjegjësimit, për t'i lehtësuar ndryshimet në normat dhe qëndrimet socio-kulturore gjinore.
- Investoni në luftimin e normave të ngurta gjinore që vazhdojnë t'i pllakosin gratë shqiptare. Një mënyrë për ta bërë këtë është nëpërmjet ofrimit të stimujve për baballarët që ta përdorin lejen prindërore dhe ofrimit të programeve të atësisë për të mësuar aftësitë e prindërimit dhe vlerën e bashkë-prindërimit.
- Promovoni përfshirjen e burrave në punën e papaguar, duke e adresuar ndarjen gjinore në shtëpi dhe në vendin e punës.
- Normalizoni pritjet kulturore për përfshirjen e barabartë të baballarëve në punën e papaguar.
- Transformoni maskulinitetet negative në nivel shoqëror, komunitet, familjar dhe individual, përmes një kurrikule të veçantë për nxënësit e shkollave prej shkollës fillore deri në shkollë të mesme.
- Krijoni hapësira për burrat dhe djemtë që t'i diskutojnë stereotipet gjinore në orët e veçanta të shkollës që i kushtohen barazisë gjinore ose dhunës ndaj grave.
- Inicioni fushata mediatike për t'i destigmatizuar dhe prishur nocionet gjinore të punës, normave dhe roleve të grave dhe burrave.
- Angazhoni më shumë burra në pozita me pagesë për kujdesin ndaj fëmijëve, për t'i avancuar normat kulturore të rolit të burrave në përkujdesje.
- Rivlerësoni vlerën e punës në shtëpi dhe punës së kujdesit, si për shoqërinë, ashtu edhe për ekonominë. Njihni dhe pranoni zyrtarisht aftësitë e fituara përmes punës së kujdesit të paguar dhe të papaguar.

Maqedonia e Veriut

Hyrje

Ekonomia e kujdesit i referohet punës dhe shërbimeve të paguara dhe të papaguara që mbështesin kujdesin në të gjitha format e saj.⁴⁴ Puna me pagesë në këtë drejtim lidhet me shërbimet e ofruara jashtë shtëpisë, për shembull kujdesi për persona të tjerë që nuk janë anëtarë të drejtpërdrejtë të familjes ose që bëjnë punë të shtëpisë jashtë shtëpisë. Ekonomia e kujdesit është ekonomikisht e vlefshme, por e nënvlerësuar globalisht.⁴⁵ Ajo mbetet e karakterizuar nga mungesa e përfitimeve dhe e mbrojtjeve, mungesa e kontratës, e pushimit me pagesë,⁴⁶ paga të ulëta ose mos kompensim, si dhe ekspozim ndaj dëmtimit fizik, mendor dhe në disa raste edhe seksual.⁴⁷

Puna e kujdesit brenda familjes i referohet kryerjes së punëve të shtëpisë si gatimi, pastrimi, larja, hekurosja ose kujdesi për anëtarët e familjes, përfshirë kujdesin për fëmijët, kujdesin për të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara ose ata që janë të sëmurë. Kjo punë zakonisht është e padukshme, e nënvlerësuar dhe e papaguar, pa një ndarje proporcionale të punës ndërmjet burrave dhe grave.⁴⁸ Tradicionalisht, gratë kanë marrë mbi supë shumicën e përgjegjësisë të kujdesit, duke rezultuar kështu me pabarazi gjinore dhe pabarazi ekonomike.

Kjo ndarje gjinore e punës ka pasur implikime të konsiderueshme si për burrat, ashtu edhe për gratë. Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore ka qenë e kufizuar për shkak të kërkesave që shtrohen ndaj përgjegjësisë të kujdesit, duke çuar në paga më të ulëta, ulje të mundësive për avancim në karrierë dhe në zgjerim të hendekut të pagave për shkak të aspektit gjinor. Burrat, nga ana tjetër, kanë qenë më pak të përfshirë në punën e kujdesit, gjë që ka kufizuar angazhimin e tyre në aktivitetet edukative dhe shtëpiake. Të kuptuarit e rëndësisë së ekonomisë së kujdesit dhe adresimi i dinamikës së saj gjinore është vendimtar për arritjen e një shoqërie më të barabartë dhe më gjithëpërfshirëse.

Ekonomia e kujdesit nuk është qenësore vetëm për mirëqenien individuale, por edhe ka implikime të konsiderueshme për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit, si formal, ashtu edhe joformal, kontribuon në funksionimin e përgjithshëm të shoqërisë dhe bën të mundur të zhvillohen aktivitete të tjera ekonomike. Megjithatë, nënvlerësimi dhe nën-investimi në punën e kujdesit mund ta pengojë zhvillimin ekonomik.

Ky dokument i shkurtër kryesisht fokusohet në vlerësimin e situatës në Maqedoninë e Veriut, duke shfrytëzuar

burimet parësore dhe dytësore të të dhënave për të shqyrtuar ndarjen e punës së papaguar në familje, me qëllim të identifikimit se kush shpenzon më shumë kohë duke u kujdesur për fëmijët ose për anëtarët e tjerë të familjes, dhe si puna në ekonominë familjare shpërndahet ndërmjet partnerëve. Ndër të tjera, koha e shfrytëzuar nga gratë dhe burrat është çështje me interes për t'i kuptuar normat shoqërore dhe faktorët themelorë që kanë ose mund të kenë ndikuar në krijimin e roleve gjinore brenda familjes maqedonase.

Statistikat zyrtare nga anketa e përdorimit të kohës dhe të punësuarit sipas sektorëve ekonomikë

Ndarja e kohës dhe mënyra se si njerëzit u japin përparësi punëve të tyre të përditshme, përfshirë punën me pagesë (zhvillimin e karrierës), punët e shtëpisë, kujdesin për të tjerët (puna pa pagesë) dhe punët për përmbushjen dhe mirëqenien personale, luan rol vendimtar në të kuptuarit e barazisë gjinore dhe të normave gjinore shoqërore. Ajo se si individët e kalojnë kohën e tyre në këto fusha, hedh dritë mbi pabarazitë e mundshme mes burrave dhe grave. Enti Shtetëror i Statistikave ka kryer Anketën mbi Shfrytëzimin e Kohës për të mbledhur informata të vlefshme për përdorimin mesatar të kohës në ditë të popullsisë në vend. Fatkeqësisht, të dhënat më të fundit që kemi për përdorimin e kohës janë nga viti 2015 kur është kryer hulumtimi. Që nga ajo kohë, nuk është publikuar ose përditësuar asnjë e dhënë e re për këto çështje. Pavarësisht këtyre kufizimeve, të dhënat ekzistuese ofrojnë njohuri të vlefshme për ndarjen e punës dhe përfshirjen e grave dhe burrave në punët e shtëpisë pa pagesë.

Në një ditë të zakonshme, njerëzit në vend e ndajnë kohën e tyre për aktivitete të ndryshme, secili duke kontribuar në pjesë të ndryshme të rutinës së tyre të përditshme.⁴⁹ Koha më e madhe, 36% (*ekuivalente me 8 orë e 44 minuta*), i kushtohet **gjumit**, qoftë gjatë natës apo ditës, si dhe çdo periudhe pushimi për shkak të paaftësisë. Duke u pasuar me 22% (*5 orë e 17 minuta*) që është **kohë e lirë**, e që përfshin shoqërimin, vizitën dhe pritjen e mysafirëve, bisedat telefonike, argëtimin, aktivitetet kulturore, sportet, shëtitjet, ecjen, përfshirjen në aktivitete artistike, përdorimin e kompjuterëve, leximin e librave ose të revistave, shikimi i televizorit, dëgjimi i muzikës dhe më shumë. **Aktivitetet shtëpiake**⁵⁰ zënë 10% (*2 orë e 25 minuta*) të ditës dhe përfshijnë një sërë punësh, si përgatitja e ushqimit, larja e enëve, pastrimi, larja e rrobave, hekurosja, zejet e dorës, kopshtaria, kujdesi për kafshët shtëpiake, riparimet në shtëpi, blerjet, kujdesi për fëmijët, si dhe aktivitete të tjera të paspecifikuara që lidhen me familjen. **Punësimi** përbën 10% (*2 orë e 30 minuta*), duke marrë parasysh si punën kryesore, ashtu edhe çdo punësim dytësor, si dhe aktivitete si pushime të shkurtra gjatë punës, udhëtime për qëllime pune, jashtë orarit, udhëtime pune, seminare etj. **Ngrënia dhe pirja** përfaqësojnë 9% (*2 orë e 14 minuta*) të aktiviteteve ditore, ndërsa 4% tjetër (*56 minuta*) i atribuohet aktiviteteve të tjera të kujdesit personal, duke përfshirë higjienën personale, kujdesin shëndetësor, marrëdhëniet intime dhe kujdesin për anëtarët e familjes, të afërmit, ose miqtë. Aktivitetet e tjera⁵¹ marrin më pak kohë gjatë ditës.⁵²

Të dhënat e anketës nxjerrin në pah qëndrueshmërinë e roleve tradicionale gjinore në ndarjen e punës. Rezultatet tregojnë se burrat ndajnë një pjesë më të madhe të kohës së tyre, afërsisht 13.5% (*ekuivalente me 4 orë e 1 minutë*), për **punën me pagesë**, për dallim nga gratë që i kushtojnë rreth 7.3% (*e barabartë me 2 orë*

e 39 minuta) të kohës së tyre për aktivitete që lidhen me punësimin. Kjo pabarazi punësimi përhapet edhe në aspekte të tjera të jetës, duke përfshirë kohën e lirë dhe përgjegjësitë shtëpiake. Si rrjedhojë, u konstatua se gratë ia kushtojnë një pjesë të konsiderueshme, afërsisht 15.6% (*ekuivalente me 3 orë e 38 minuta*), të kohës së tyre **aktiviteteve shtëpiake**, që është tre herë më shumë se 5% (*e barabartë me 1 orë e 11 minuta*) të kohës që burrat ndajnë për detyra të tilla.⁵³ Kjo mospërputhje nxjerr në pah barrën jo proporcionale që vendoset mbi gratë lidhur me përgjegjësitë shtëpiake.

Edhe në mesin e popullatës së punësuar, vazhdon të ketë një hendek të konsiderueshëm gjinor në përgjegjësitë shtëpiake, me gratë që mbajnë pjesën më të madhe të barrës në masën marramendëse 14% (*e barabartë me 3 orë e 14 minuta*), ndërsa burrat e punësuar kontribuojnë me vetëm 5% (*e barabartë me 1 orë e 10 minuta*) për këto detyra. Pas shqyrtimit më nga afër të aktiviteteve shtëpiake, detyrat specifike i zbulojnë pabarazitë gjinore që janë edhe më të theksuara. Veçanërisht, përgatitja e ushqimit zë një masë të konsiderueshme 35% (*e barabartë me 1 orë e 11 minuta*) të ngarkesës shtëpiake të grave, ndërsa përbën vetëm 7.9% (*e barabartë me 9 minuta*) të përgjegjësisë të burrave. Në mënyrë të ngjashme, larja e enëve përbën 8.5% (*e barabartë me 27 minuta*) të detyrave shtëpiake të grave, ndërsa është vetëm 1.4% (*e barabartë me 1 minutë*) të përgjegjësisë të burrave.⁵⁴

Përveç ndarjes së pabarabartë të punëve të shtëpisë, konstatohet se gratë e punësuar kanë po ashtu më pak kohë për aktivitete të lira krahasuar me burrat. Konkretisht, gratë ndajnë 15,1% të kohës së tyre (*e barabartë me 3 orë e 39 minuta*) për aktivitete të kohës së lirë, ndërsa burrat e kanë privilegjin t'ia kushtojnë 19,1% të kohës së tyre (*e barabartë me 4 orë e 35 minuta*) aktiviteteve të tilla.⁵⁵

Kjo e dhënë nxjerr në pah një tendencë të konsiderueshme lidhur me kohën e shpenzuar për aktivitetet shtëpiake nga gratë dhe burrat e grup moshës 25 deri në 44 vjeç.⁵⁶ Gjatë kësaj periudhe, koha që shpenzojnë që gratë për punët e shtëpisë rritet ndjeshëm, ndërsa ulet për burrat e së njëjtës moshë. Ky model paraqet një tablo të qartë të një strukture familjare patriarkale, ku gratë mbajnë pjesën më të madhe të përgjegjësisë që lidhen me kujdesin ndaj fëmijëve, kujdesin për të moshuarit dhe të obligimeve të tjera familjare. Rrjedhimisht, gratë e papuna shpesh e gjejnë veten duke iu kushtuar kohën e tyre punëve të shtëpisë, gjë që i lë ato me mundësi të kufizuara për të fituar shkathësi të reja ose për të fituar përvojë pune, gjë që do të mund ta rriste konkurrencën e tyre në tregun e punës. Kjo situatë ka ndikim të drejtpërdrejtë në kohën e lirë dhe zhvillimin personal të grave. Duke qenë se ato një pjesë të konsiderueshme të kohës iu kushtojnë roleve në shtëpi, ato kanë më pak mundësi për t'u përfshirë në aktivitete kulturore, sportive, vullnetarizëm dhe aktivitete të tjera të kohës së lirë. Shpërndarja e pabarabartë e punëve të shtëpisë dhe e përgjegjësisë të kujdesit bën jo vetëm që të vazhdojnë në pambarim rolet tradicionale gjinore, por kjo e pengon edhe përparimin e grave në fusha të ndryshme të jetës.

Gra dhe burra të punësuar sipas sektorëve ekonomikë

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave gjithsej janë të punësuar 287.360 gra. Në mesin e këtyre grave të punësuar, përqindja më e madhe, që përbëhet nga 64,611 punëtore, gjenden në sektorin e prodhimit. Më pas në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, riparimin e automjeteve dhe motoçikletave,

ku janë të punësuar 49,207 gra.⁵⁷ Në sektorin e shëndetit të njeriut dhe në aktivitetet e punës sociale, ka 35,583 punonjëse gra, që e tejkalojnë numrin prej 10,932 burra të punësuar në të njëjtën fushë. Kalojmë te arsimiti 29,461 gra janë të punësuar krahasuar me 18,290 burra. Në fund, sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe i peshkimit ka gjithashtu përfaqësim të konsiderueshëm të grave në fuqinë punëtore të përgjithshme të punësuar, me 24,597 gra që punojnë në mënyrë aktive.⁵⁸

Nëse e shqyrtojmë shpërndarjen e punonjësve në sektorë të ndryshëm të aktivitetit të shprehur si %, bëhet e qartë se pjesa më e madhe e fuqisë punëtore në sektorët e mëposhtëm përbëhet nga gratë: Shëndeti i njeriut dhe aktivitetet e punës sociale (76.5%); Arsimiti (61,7%); Veprimtaritë e organizatave dhe trupave ekstraterritoriale (56,5%); Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike (56,4%); dhe Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve (56.4%). Nga ana tjetër, burrat përbëjnë një pjesë më të vogël të fuqisë punëtore të punësuar në këta sektorë.⁵⁹

Mund të vërehet se burrat përbëjnë pjesën më të madhe të të punësuarve në aktivitete si ndërtimi (91.3%), minierat dhe guroret (90.5%), transporti dhe magazinimi (88.7%), furnizimi me ujë, kanalizimet, menaxhimi i mbetjeve dhe aktivitetet e rehabilitimit (82.4%), dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (74.8%). Gjithashtu, mbi 60% e fuqisë punëtore në sektorët e administratës publike dhe të mbrojtjes, sigurimi social i detyrueshëm (68.3%), informacioni dhe komunikimi (66.3%), shërbimet e akomodimit (65.4%), bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (64.4%), dhe aktivitetet e pasurive të paluajtshme (62.6%) janë gjithashtu burra.⁶⁰

Pabarazitë e vërejtura gjinore në shpërndarjen e fuqisë punëtore të punësuar nëpër sektorë të ndryshëm ekonomikë, mund të tregojnë se ka ndarje profesionale, p.sh., gratë shihen si më të përshtatshme për kujdesin shëndetësor dhe arsim, ndërsa burrat janë për ndërtim ose transport. Për më tepër, ende ka stereotipe gjinore të rrënjosura thellë dhe norma sociale që ndikojnë në zgjedhjet dhe mundësitë për karrierë. Që në moshë të re, vajzat inkurajohen të ndjekin karrierë në profesione tradicionalisht "për femra", si ato në sektorët e shëndetësisë, kujdesit social, arsimit ose administratës publike.

Kjo ndarje e punës dhe e roleve të punës është e rrënjosur thellë si në sistemin arsimor, ashtu edhe në shoqërinë më të gjerë, duke vazhduar ndër breza.⁶¹ Fatkeqësisht, kjo qasje gjinore ndaj karrierës ndikon në vetëbesimin e vajzave dhe kërkon mbështetje shtesë gjatë viteve të shkollës së mesme, në krahasim me djemtë. Studimi "Vajzat në Teknologji" zbuloi se vajzat që në moshë të re dhe gjersa janë në procesin arsimor janë të vetëdijshme për stereotipet gjinore që i pengojnë zgjedhjet e tyre të karrierës.⁶² Ato vërejnë se shoqëria ka pritshmëri prej tyre dhe vajzat mund të përballen me sfida dhe barriera shoqërore kur aspirojnë të bëhen, p.sh., mekanike të veturave ose të konkurrojnë në profesione tradicionalisht "për meshkuj".⁶³ Një arsye tjetër, ndër tjerash, mund të jetë edhe balanca punë-jetë dhe përgjegjësitë e kujdesit. Siç kemi vërejtur në të dhënat e paraqitura për shfrytëzimin e kohës, nuk ka ndarje të barabartë të punës pa pagesë në amvisëri. Gratë shpesh kanë një pjesë jo proporcionale të kujdesit që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të ndjekur karriera të caktuara të punës me orë më të gjata.

Normat shoqërore dhe perceptimi i grave mbi ekonominë e kujdesit dhe ndarjen e punës së paguar

Vendi ka bërë hapa të rëndësishëm në ndjekjen e barazisë gjinore, me miratimin e legjislacionit gjithëpërfshirës që përputhet me konventat themelore dhe normat e pranuar gjerësisht. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, disa norma të rrënjësura sociale vazhdojnë ende, duke çuar në pabarazi gjinore dhe diskriminim në tregun e punës.

Një shqetësim urgjent është se 55.6% e grave janë joaktive⁶⁴ në tregun e punës.⁶⁵ Ky jo aktivitet mund t'i atribuohet disa faktorëve, por kryesor është mbizotërimi i roleve tradicionale gjinore në shoqëri, të cilat bëhen edhe më të theksuara pas martesës ose pas lindjes së fëmijëve. Shumë gra zgjedhin të mbeten joaktive dhe e përqafojnë rolin e amviseve me kohë të plotë, duke i kushtuar tre herë më shumë kohë aktiviteteve shtëpiake sesa burrat.⁶⁶ Sipas Entit Shtetëror të Statistikave, një pjesë e konsiderueshme e grave joaktive, ose 41%, klasifikohen si amvise. Koha që gratë në vend⁶⁷ iu kushtojnë aktiviteteve shtëpiake rritet ndjeshëm për grup moshën e grave nga 25 në 44 vjeç, ndërsa zvogëlohet për burrat e së njëjtës moshë⁶⁸, që sugjeron se ka pabarazi gjinore. Për rrjedhojë, gratë e papuna e gjejnë veten duke i kushtuar kohën dhe energjinë e tyre përmbushjes së këtyre detyrimeve, duke u lënë atyre mundësi të kufizuara për të fituar shkathtësi të reja ose për të fituar përvojë pune, duke e penguar kështu konkurrencën e tyre në tregun e punës.

Për më tepër, vlen të përmendet se disa masa, si mbyllja e kopshteve tre vjet më parë (për shkak të COVID-19), mund të ketë institucionalizuar pa dashje rolet dhe stereotipet gjinore. Për shembull, u zbatua një masë që lejonte njërin prind të fëmijëve më të vegjël se dhjetë vjeç të lirohej nga puna për të ofruar kujdesin për fëmijën. Fatkeqësisht, kjo rezultoi që vetëm çdo i pesti prind të ishte baba, duke bërë që nënat të merrnin tre të katërtat e barrës së gjithmbarshme të kujdesit.⁶⁹ Përvetësimi më i ulët i kësaj mase nga burrat mund t'i atribuohet faktit se ata zakonisht mbajnë punë më të sigurta dhe shpesh më të paguara, duke e përforcuar kështu stereotipin gjinor tradicional të burrave si mbajtësit kryesorë të familjes. Ky shembull ilustron se si politika të caktuara mund t'i përforcojnë rolet ekzistuese gjinore, ku nga gratë pritet që t'i japin përparësi përgjegjësi të kujdesit, ndërsa burrat shihen si operatorët kryesorë në fuqinë punëtore. Në këtë drejtim, gjetjet e Indeksit të Barazisë Gjinore tregojnë se gratë në Maqedoninë e Veriut fitojnë më pak dhe janë në rrezik më të lartë nga varfëria krahasuar me burrat. Të ardhurat më të ulëta, kohëzgjatja më e shkurtër e ciklit të punës me 10 vjet dhe pasiviteti më i lartë në tregun e punës, kontribuojnë në një rrezik më të lartë nga varfëria dhe cënueshmëria ekonomike.⁷⁰

Joaktiviteti i grave në fuqinë punëtore dhe vështirësitë në gjetjen e një pune të denjë mund t'i atribuohen roleve të tyre tradicionale riprodhuese, shpesh duke kërkuar nga to që t'i japin përparësi përgjegjësi të kujdesit ndaj fëmijëve. Më të ndërlikuar këtë çështje e bën edhe disponueshmëria e pamjaftueshme e mjediseve, veçanërisht e kopshteve, gjë që e bën të vështirë për nënat balancimin e obligimeve të punës dhe familjes. Studimet e mëparshme kanë treguar një mungesë të konsiderueshme të vendeve të lira nëpër çerdhe, një problem që vazhdon në çdo komunë të vendit.⁷¹

Perceptimi i grave në ekonominë e kujdesit dhe ndarja e punës së papaguar

Si pjesë e këtij aktiviteti, ne organizuam dy diskutime në fokus grupe që përfshinin një grup të ndryshëm grash me prejardhje të ndryshme personale, arsimore dhe profesionale, me pjesëmarrës të grup moshave të ndryshme. Gjatë gjithë këtyre diskutimeve, gratë ndanë hapur me ne përvojat dhe perspektivat e tyre në lidhje me ndarjen e punës dhe kohën që shpenzojnë për aktivitete shtëpiake të papaguara. Në këto aktivitete hynte një gamë të gjerë detyrash, përfshirë gatimin, pastrimin, larjen e rrobave, kujdesin për fëmijët dhe ofrimin e kujdesit për anëtarët e familjes.⁷²

Ndonëse ekziston një ndërgjegjësim në rritje për nevojën për një ndarje të drejtë të punës së papaguar sot, tradicionalisht, gratë shpesh kanë mbajtur të gjithë barrën e punëve të shtëpisë, sidomos nëse ishin të papuna. Pjesëmarrësit pranuan se ndarja e punës brenda familjes varej nga statusi i punësimit të partnerëve. Nëse të dy janë të punësuar, detyrat e shtëpisë duhet të ndahen. Është interesante se punët e caktuara të shtëpisë ende shiheshin sipas roleve tradicionale gjinore. Për shembull, riparimet e pajisjeve shtëpiake dhe puna në oborr zakonisht pritej të kryheshin nga burrat, ndërsa pastrimi nga gratë.

Nënat beqare, nga ana tjetër, shpesh marrin ndihmë nga fëmijët e tyre. Gjatë diskutimeve, një pjesëmarrëse, një nënë e shkukurëzuar që jeton me dy fëmijë, theksoi se si funksiononin si ekip në menaxhimin e punëve të shtëpisë. Pavarësisht kufizimeve financiare të fëmijëve të saj si studentë, ata merrnin pjesë aktive në ndarjen dhe kryerjen e punëve të shtëpisë.

Kur gratë fillimisht i lejojnë partnerët e tyre të shmangin punët e shtëpisë, kjo mund të krijojë një model ku burrat pranojnë dhe përmbahen nga pjesëmarrja në punë të tilla. Pavarësisht disa përparimeve, shumë pjesëmarrës u shprehën se ndarja e punës nuk ishte plotësisht e barabartë. Ndonëse bashkëshortët ose partnerët kontribuojnë në punët e papaguara të shtëpisë në një farë mase, gratë shpesh e ndejnë barrën më të rëndë. Burrat, në përvojën e tyre, treguan interes të kufizuar për të mësuar punët e shtëpisë dhe prireshin t'i shmangnin punët e tilla si larja e enëve. Përdorimi i pajisjeve shtëpiake, si makina rrobolarëse, u citua si shembull ku burrat “nuk dinë ta përdorin atë”.

Gjersa arsimimi dhe edukimi ndikojnë në zhvillimin e personalitetit, gratë në përgjithësi besojnë se u takon atyre të vendosin se çfarë do të jetë dhe çfarë nuk do të jetë kurrë pjesë e marrëdhënies së tyre me partnerin. Një pjesëmarrëse ndau një shembull personal nga familja e saj. Babai i saj mori një rol aktiv në punët e shtëpisë, duke përfshirë larjen e enëve dhe gatimin. Pavarësisht vullnetit të babait të saj për të marrë pjesë, ajo reflekton mbi mundësinë që ndonjëherë vetë gratë mund t'i përforcojnë pa dashje rolet tradicionale gjinore në marrëdhëniet e tyre. Ajo e cek se nuk mund ta ndryshojë lehtësisht sjelljen e burrit të saj nëse është e martuar për një kohë të gjatë, duke theksuar kompleksitetin e ndryshimit të modeleve tashmë të vendosura.

Kur u pyetën se kush mund të ndikojë tek burrat që të mos marrin pjesë në punët e shtëpisë, pjesëmarrësit theksuan se prindërit mund të luajnë rol në formësimin e këtyre bindjeve. Një pjesëmarrëse kujtoi me humor një incident nga e kaluara e saj, ku ajo inkurajoi djalin e saj të përdorte një fshesë të rrymës. Babai

i tij me sa duket e dekurajoi atë që të provonte përsëri detyra të tilla. Kjo anekdotë thekson se si nocionet e paramenduara dhe përvojat negative mund t'i pengojnë burrat të marrin pjesë në punët e shtëpisë.

Gjatë diskutimeve mbi kohën e caktuar për punët e papaguara të shtëpisë, pjesëmarrësit theksuan se punë të tilla si larja e rrobave ose pastrimi mund të kërkojnë shumë kohë. Shumica e grave shprehën besimin e tyre se vazhdojnë të investojnë më shumë përpjekje dhe kohë në punët e shtëpisë në krahasim me partnerët e tyre burra, me vlerësime që sillen nga 60% në 80% të detyrave të përgjithshme. Kjo mospërputhje shpesh iu atribuohet faktorëve të ndryshëm, të tillë si partnerët e tyre që nuk i kryejnë mirë punët ose thjesht nuk janë të gatshëm të kontribuojnë në ato përgjegjësi.

Një pjesëmarrëse shprehu një ndjenjë të përbashkët, duke deklaruar se ndonëse ajo mund të pretendojë se është një ndarje 50-50 e punës kur bëhet fjalë për punë më sfiduese si pastrimi, ajo gjithnjë përfundon duke kryer pjesën më të madhe. Ajo preferon ta trajtojë vetë pastrimin sesa t'i ndërrojë punët dhe të jetë e pakënaqur me rezultatet e partnerit të saj. Kjo vëmendje ndaj detajeve dhe preferenca për kontroll kontribuojnë në ngarkesën më të rëndë të punës që ajo merr përsipër. Një tjetër pjesëmarrëse preferon ta bëjë vetë pastrimin dhe gjersa i shoqi i nxjerr fëmijët jashtë, ajo zgjedh të qëndrojë brenda shtëpisë dhe të bëjë pastrimin.

Për sa i përket kujdesit për fëmijët dhe ndihmesës për punët e shtëpisë, gratë në përgjithësi marrin më shumë përgjegjësi. Megjithatë, burrat përfshihen në aktivitete të tilla si takimet e prindërve dhe mësuesve, dërgimi ose marrja e fëmijëve nga kopshti ose shkolla. Në rastet kur ka shumë fëmijë, të dy partnerët nuk kanë zgjidhje tjetër veçse t'i ndajnë këto punë, shpesh duke marrë pjesë në takime të veçanta njëkohësisht. Në situatat kur fëmijët janë të sëmurë, janë kryesisht nënat ato që marrin pushim nga puna për t'u kujdesur për ta. Kjo tregon se gratë shpesh bëjnë sakrificë në karrierë për shkak të normave sociale dhe pritshmërive që lidhen me kujdesin. Këto pritshmëri mund të krijojnë çekuilibër në dinamikën e punës dhe të jetës, duke ndikuar në rritjen profesionale dhe mundësitë e grave.

Nga diskutimet u bë e qartë se gratë luftojnë për të gjetur kohë për veten për shkak të kërkesave të shumta të punëve të shtëpisë. Kur u pyetën se si do ta kalonin kohën e lirë nëse barra e punëve të shtëpisë do të ndahej në mënyrë më të barabartë, ato shprehën dëshirën për t'u përfshirë në aktivitete rekreative me familjet e tyre, duke i kushtuar gjithashtu vetes kohë për të ndjekur interesat personale. Nga ana tjetër, sipas përvojës së tyre, burrat përgjithësisht kanë më shumë fleksibilitet sa i përket menaxhimit të kohës së tyre gjatë ditës, pasi nuk janë të mbingarkuar me punët e shtëpisë.


Pjesëmarrësit theksuan se çështjet e diskutuara më lart i kanë rrënjët në një moshë të hershme të socializimit. Vajzat priren të ekspozohen ndaj lodrave dhe aktiviteteve që i përforcojnë rolet tradicionale gjinore, duke i theksuar rolet e tyre si kujdestare dhe shtëpiake. Nga ana tjetër, djemtë inkurajohen të luajnë me lodra si vetura apo avionë që konsiderohen më "mashkullorë", ku mund të mos përfshihen përgjegjësi shtëpiake. U vu në pah edhe ndikimi i prindërve, pasi disa i rrisin djemtë pa i përfshirë që në moshë të re në ndarjen e punës brenda familjes.

Analiza e të dhënave të anketës


Në kuadër të këtij aktiviteti u realizua një anketë e shkurtër online për t'i shqyrtuar rolet e grave dhe burrave nga Maqedonia e Veriut në lidhje me ndarjen e punëve të papaguara të shtëpisë duke përfshirë edhe kujdesin ndaj fëmijëve. Pyetësi përbëhej nga 10 pyetje, dhe të dhënat u mblodhën nga një përzgjedhje e rastësishme e të anketuarve që kishin qasje në linkun në dispozicion.

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që e plotësuan pyetësin online, 72.7% ishin gra, 24.2% ishin burra dhe 3% të identifikuar si të tjerë. Të gjithë të anketuarit jetojnë në qytet apo në zonë urbane.

Grafiku 7. Të anketuarit sipas gjinisë



Grafiku 8. Të anketuarit sipas moshës




Sipas strukturës moshore të paraqitur në grafik, vërehet se pjesa më e madhe e të anketuarve, ose 54.5%, hyjnë në grup moshat 33 deri në 45 vjeç. Grup moshë tjetër e rëndësishme është mes 46 dhe 54 vjeç, që përbëjnë 18.2% të të anketuarve. Grup moshë prej 25 deri në 32 vjeç përfaqësohet me 12,1%, ndërsa moshat 54 deri në 65 vjeç përbëjnë 9,1% të popullsisë së anketuar. Grup moshë më e re, individët prej 15 deri në 24 vjeç, përbëjnë vetëm 6.1%.

Sa i përket nivelit më të lartë të arsimit, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 93.9% janë me diplomë universitare ose diplomë kolegji, ndërsa 6.1% me arsim të mesëm.


Nëse analizohet gjendja ekonomike e të anketuarve mund të vërehet se shumica prej tyre ose 93.9% janë të punësuar. Nga të punësuarit, 54.5% janë të punësuar në sektorin publik, ndërsa 39.4% në sektorin privat. Të anketuarit e mbetur ndahen në dy kategori: të papunë (3%) dhe ata që janë të papunë por që nuk janë duke kërkuar punë në mënyrë aktive (3%). Të pyetur se pse nuk po kërkonin punë, arsyeja ishte pagat e ulëta.

Grafiku 9. Të anketuarit sipas shkollimit



Të anketuarit janë pyetur se me cilat punë të shtëpisë merren më shumë. Pjesa më e madhe prej tyre, 42.4%, janë përgjigjur se janë të përfshirë kryesisht në pastrim, 18.2% në kujdesin për fëmijët dhe 12.1% në gatim. Gjithashtu, 3% thanë se janë të përfshirë kryesisht në kujdesin për të moshuarit dhe 3% e tjerë e përmendën hekurosjen si detyrën e tyre kryesore. Është interesante se 6% sish deklaruan se kryejnë një kombinim të detyrave të lartpërmendura. Nga ana tjetër, nja 15.1% e dukshme janë përgjigjur se nuk angazhohen në asnjë nga aktivitetet e renditura.


Grafiku 10. Të anketuarit sipas gjendjes ekonomike



Kur u pyetën për ndarjen e punëve të shtëpisë, shumica e të anketuarve, me 93.9%, shprehën besimin se të dy partnerët duhet t'i ndajnë përgjegjësitë. Nga ana tjetër, vetëm 6.1% besonin se vetëm gratë duhet të jenë përgjegjëse për punët e shtëpisë.

Sa u përket përgjegjësiave për kujdesin ndaj fëmijëve, edhe një herë, një shumicë e konsiderueshme, që përbën 90,9% të të anketuarve, besojnë se të dy prindërit duhet t'i ndajnë detyrat e kujdesit. Për dallim nga kjo, një pjesë më e vogël, 9.1%, deklaruan se kryesisht nënat duhet të jenë përgjegjëse për t'u kujdesur për fëmijët.

Grafiku 11. Me cilat punë të shtëpisë merreni më shumë?



Shumica e të anketuarve, saktësisht 66.7%, më së shumti orë në ditë i kushtojnë punës me pagesë. Ndër të tjera, 6.1% e tyre e ndajnë kohën e tyre për kujdesin ndaj fëmijëve dhe 6.1% sish për blerjet ushqimore. Një pjesë dukshëm më e vogël e pjesëmarrësve e kalojnë pjesën më të madhe të ditës në aktivitete të kohës së lirë, kujdes për veten ose punës në kopsht.

Grafiku 12. Kush duhet të merret me punët e shtëpisë?



Përfundim

Pabarazitë gjinore në punën e papaguar ndikojnë thellë në cilësinë e jetës së grave dhe në zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Shpërndarja e pabarabartë e punëve të shtëpisë vendos një barrë të konsiderueshme mbi gratë, duke i lënë ato me kohë të kufizuar për ndjekjen e interesave personale dhe të kujdesit për veten. Për dallim nga kjo, burrat shpesh gëzojnë fleksibilitet më të madh në menaxhimin e kohës së tyre, pasi nuk janë të ngarkuar me të njëjtën masë të punëve qenësore të shtëpisë. Kjo pabarazi jo vetëm që ishte e evidente në të dhënat statistikore, por edhe u confirmua përmes diskutimeve që u zhvilluan mbi këtë temë.

Si shoqëria, ashtu edhe institucionet publike luajnë rol jetik në adresimin e çështjes së punës së papaguar. Ato duhet të bashkëpunojnë për t'u fokusuar në edukimin dhe nismat për rritjen e ndërgjegjësimit që hedhin dritë mbi rëndësinë e punës së papaguar. Këto përpjekje duhet të përfshijnë aktivitete promovuese që synojnë sfidimin e stereotipeve ekzistuese që lidhen me ndarjen e punës së papaguar, ndërkohë që e theksojnë vlerën e punës së papaguar dhe të kujdesit. Duke vepruar kështu, ne mund t'i transformojmë gradualisht qëndrimet e shoqërisë ndaj këtyre përgjegjësive. Për më tepër, është qenësore të kultivohet një kulturë vlerësimi dhe njohjeje për punën dhe kujdesin e papaguar, jo vetëm brenda familjeve, por në shoqëri si tërësi.

Është inkurajuese që përmes hulumtimit të identifikohet se disa familje po i sfidojnë këto norma tradicionale duke përdorur një qasje më të ekuilibruar për ndarjen e detyrave. Kjo gjë ilustron se ndryshimi është i mundur kur bëhen përpjekje të ndërgjegjshme për t'u shkëputur nga rolet dhe pritjet e ngurta gjinore. Për ta arritur një shoqëri më të barabartë, është qenësore të promovohen biseda të hapura rreth përgjegjësive të përbashkëta brenda familjeve dhe ndryshimi i tyre, duke inkurajuar të gjithë anëtarët e familjes të marrin pjesë në një gamë të gjerë aktiviteteve shtëpiake dhe të kujdesit, pavarësisht nga gjinia e tyre.

Është qenësore t'i jepet përparësi zbatimit të politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor në nivel kombëtar. Politikëbërësit duhet ta marrin iniciativën për të hartuar dhe miratuar politika publike efektive dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë që e adresojnë drejtpërdrejt ndarjen ekzistuese të pabarabartë të punës së papaguar dhe të përgjegjësive të kujdesit. Politika të tilla duhet të përqipen ta promovojnë lejen prindërore për nënat dhe baballarët, të ofrojnë mbështetje financiare ose subvencione për kostot e kujdesit ndaj fëmijëve, si dhe të ofrojnë stimuj për kompanitë që e inkurajojnë aktivisht ekuilibrin punë-jetë për punonjësit e tyre.

Politikat publike që mbështesin balancimin punë-jetë duhet t'u mundësojnë grave dhe burrave t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre si në shtëpi, ashtu edhe në karrierë, pa e vënë në rrezik njërin për tjetrën. Si përfundim, adresimi i ndarjes së pabarabartë të punës së papaguar të shtëpisë kërkon përpjekje kolektive nga individët, familjet dhe shoqëria në tërësi. Duke sfiduar rolet tradicionale gjinore, duke promovuar komunikim të hapur dhe duke avokuar për politika mbështetëse, ne mund të përqipemi drejt një të ardhmeje ku gratë të kenë më shumë kohë për zhvillim personal dhe një ndarje më të drejtë të përgjegjësive lidhur me punët e shtëpisë. Një ndryshim i tillë do të çonte në fuqizim më të madh ekonomik për gratë dhe në një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe më progresive në përgjithësi.

Mali i Zi

Hyrje

Mali i Zi ka një ekonomi të vogël të hapur që kryesisht bazohet në sektorin e shërbimeve, të turizmit dhe të tregtisë. Kjo është arsyeja pse COVID-19 ndikoi ndjeshëm në vend dhe aktiviteti ekonomik u ul me gati 16% në vitin 2020. PBB-ja e Malit të Zi në vitin 2020 ishte 4,186 milionë euro ose 6,737 euro për kokë banori. Gjatë vitit 2021 ekonomia malazeze filloi të rimëkëmbet dhe u arrit një rritje reale e PBB-së prej 12.4%. Rritja më së shumti i është atribuar rritjes së aktivitetit turistik, por trende pozitive janë shënuar edhe në tregti, transport dhe industri. Në tremujorin e parë të 2022, PBB-ja reale u rrit me 7.2%. Megjithatë, shpërthimi i luftës në Ukrainë dhe zhvillimet përcjellëse e kanë përkeqësuar ndjeshëm perspektivën e Malit të Zi në vitin 2022. Për shembull, Banka Botërore po e ul normën e parashikuar të rritjes në 3.6%, nga një vlerësim prej 5.9% para luftës. Pritet që lufta të ketë ndikim të madh në turizëm, i cili më pas do të shkaktojë ulje të konsumit dhe do të ndikojë negativisht në punësim.

Edhe pse kontribuesit kryesorë në rritjen ekonomike janë sektorët tradicionalë, vitet e fundit sektorët e rinj si shërbimet financiare, shërbimet e TI-së dhe sektori i shërbimeve kreative kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritje në zhvillimin ekonomik. Pritet që këta sektorë të vazhdojnë ta rrisin peshën e tyre në aktivitetin ekonomik në të ardhmen.

Për shkak të aktivitetit të kufizuar ekonomik, papunësia ishte një sfidë e konsiderueshme gjatë viteve të fundit në Mal të Zi. Numri i përgjithshëm i të papunëve në vitin 2021 ishte 42.2 mijë ose 16.6% që është niveli më i lartë i papunësisë në periudhën kohore që nga viti 2005. Nga ana tjetër, numri i të punësuarve, pas një rënie të madhe gjatë gjysmës së parë të vitit, u rrit gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit si manifestim i rritjes së aktivitetit ekonomik. Kështu, në fund të vitit 2021, shkalla e punësimit ishte 51%.¹

1 MONSTAT, shkalla e punësimit 2021

Barazia Gjinore

Sipas regjistrimit të vitit 2011, regjistrimi i fundit që kemi në dispozicion, në Mal të Zi ka 620,029 banorë, 50.6% e tyre janë gra. Në vitin 2011, nga të gjithë fëmijët e lindur të gjallë në Mal të Zi, 52% ishin djem dhe 48% ishin vajza (IPSOS, 2015b).

Pas rifitimit të pavarësisë në vitin 2006, Mali i Zi si anëtar i OKB-së dhe anëtar i OSBE-së, Mali i Zi e nënshkroi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 2006 dhe u bë anëtar i 47-të i Këshillit të Evropës në vitin 2007. Në vitin 2017 u bë anëtar i NATO-s. Mali i Zi i filloi negociatat me BE-në në qershor të vitit 2012. Mali i Zi i ka ratifikuar të gjitha dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare dhe i ka integruar ato në kornizën e vet ligjore, duke krijuar kështu parakushtet për zhvillimin e politikave dhe masave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe arritjen e barazisë gjinore.

Korniza ligjore në këtë fushë është e definuar, krahas Kushtetutës, me **Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit**, të miratuar në vitin 2010, dhe **Ligjin për Barazinë Gjinore** të miratuar në vitin 2007. Ndërsa sa i përket kornizës strategjike kombëtare, **Strategjia Kombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm të Malit të Zi deri në vitin 2030**, u miratua në vitin 2016. Në këtë kuptim, masat dhe nën-masat e përcaktuara në kuadër të objektivit strategjik “Nxitja e marrëdhënieve aktive të palëve kryesore të interesit drejt qëndrueshmërisë së zhvillimit” 15 janë në përputhje me OZHQ516.

Disa nga rezultatet e pritshme deri në vitin 2030 janë:

- eliminimi i diskriminimit politik, ekonomik dhe i çdo diskriminimi tjetër me bazë gjinore;
- të paktën 40% e grave në organet politike vendim-marrëse në nivel kombëtar dhe lokal;
- eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj të gjitha grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore;
- pjesëmarrja e barabartë gjinore në punën e papaguar;
- përqindja e barabartë gjinore në papunësi;
- Forcimi i mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore.

Një dokument tjetër i rëndësishëm që harton masa që lidhen me barazinë gjinore është **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore në Mal të Zi 2021–2025**. Strategjia bazohet në vlerësimin e Planit të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore 2017-2021. Plani që ka skaduar gati dy vjet më parë, bazohej në tetë fusha të Deklaratës së Pekinit dhe të Platformës për Veprim në të cilat Mali i Zi zgjodhi të veprojë. Objektiv i kryesor strategjik i strategjisë së re është *“Arritja e niveleve më të larta të barazisë gjinore në Mal të Zi deri në vitin 2025”*.

Objektivat operative janë përmirësimi i zbatimit të kornizës ekzistuese normative në lidhje me politikën e barazisë gjinore dhe të mbrojtjes nga diskriminimi me bazë gjinore, si dhe përmirësimi i politikave të arsimit, të kulturës dhe medias, për të ulur nivelin e stereotipeve dhe të paragjyqimeve ndaj grave dhe personave me identitete të ndryshme gjinore. Objektiv i përfundimtar operativ është rritja e pjesëmarrjes së grave dhe të personave me identitete të ndryshme gjinore në zonat që ofrojnë qasje në burimet natyrore dhe sociale dhe përfitimet nga shfrytëzimi i tyre. Disa nga masat specifike janë:

- Standardizimi i procedurave për formësimin e politikave publike;
- Edukimi i punonjësve dhe stafit drejtues nëpër institucione për çështjet dhe konceptet kyçe në fushën e barazisë gjinore dhe detyrimet e tyre në fushën e barazisë gjinore sipas ligjit;
- Futja e përmbajtjes së përgjegjshme nga aspekti gjinor dhe përdorimi i detyrueshëm i gjuhës së ndjeshme nga aspekti gjinor në programe dhe në mësimdhënie;
- Inkurajimi i mediave që të prezantojnë programe të përgjegjshme në aspektin gjinor, si dhe të përdorin gjuhë të ndjeshme në aspektin gjinor;
- Organizimi i fushatave për shpërndarje më të barabartë të punës në shtëpi, të kujdesit për fëmijët, të moshuarit, për personat me aftësi të kufizuara, etj., ndërmjet burrave dhe grave, si dhe monitorimi i rregullt i të dhënave për pjesëmarrjen e burrave dhe grave në kujdesin e papaguar dhe në punët e shtëpisë;

Fuqizimi i grave dhe i njerëzve me identitete të ndryshme gjinore që të marrin pjesë në vendim-marrjen politike. Sipas Profilit Gjinor për vitin 2021, të publikuar nga UNDP dhe Ministria e Drejtësisë, e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave (UNDP; 2021), shoqëria malazeze mbetet patriarkale, megjithëse është e qartë se legjislacioni dhe politikat kanë ndryshuar dhe kanë kontribuar ndjeshëm në progresin sa i përket barazisë gjinore. Në raport konfirmohet se rolet tradicionale gjinore dhe stereotipet gjinore vazhdojnë në të gjitha sferat e jetës, veçanërisht në shtëpi, në jetën politike, tregun e punës dhe arsim. Prania dhe ndikimi i madh i normave zakonore reflektohet veçanërisht në trashëgimi, në pronësinë mbi tokën dhe pronat e paluajtshme – të dhënat tregojnë se gratë janë pronare të vetëm 4% të shtëpive dhe 8% të tokës. Përfaqësimi i grave në organet vendim-marrëse dhe pozitat drejtuese në sferën ekonomike mbetet i ulët. Megjithatë, një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së grave në jetën politike është e evidente dhe kjo po ashtu shkakton dhunë ndaj tyre, veçanërisht në sferën publike.

Edhe pse gratë janë më të arsimuara se burrat, ato ende përfaqësojnë shumicën e të papunëve. 67% e titullarëve të diplomave specialistike dhe 61% e titullarëve të masterit janë gra, por gratë përbëjnë 44% të popullsisë së punësuar dhe aktive. Për më tepër, në raport vihet në dukje disa sektorë ku gratë mbeten të padukshme për sa i përket politikave specifike, si ndryshimi i klimës, energjia dhe transporti. Më e rëndësishmja, në raport theksohet se dhuna ndaj grave, në format e saj të ndryshme, është ende shkelja më e përhapur e të drejtave njerëzore të grave.

Indeksi i Barazisë Gjinore² jep gjithashtu një pasqyrë të mirë të pozitës së grave në vend. Sipas të dhënave më të fundit që janë në dispozicion nga Enti Kombëtar i Statistikave, Indeksi i Barazisë Gjinore në Mal të Zi (MONSTAT, 2023) për vitin 2023 është 59.3, që tregon një rritje prej 4.3 të vlerës të indeksit krahasuar me indeksin nga viti 2019. Krahasuar me BE-27, Mali i Zi shënon një vlerë më të ulët të indeksit me 9.3 pikë indeksi. Indeksi i fushave kryesore të barazisë gjinore e shfaq hendekun më të lartë të barazisë gjinore në fushën e parasë (vlera më e ulët e indeksit me 20,7 pikë indeksi krahasuar me mesataren e BE-27), ndërsa hendeku më i ulët në Mal të Zi krahasuar me mesataren e BE-27 është në fushën e shëndetësisë (vlera më e ulët e indeksit me 0.8 pikë indeksi krahasuar me mesataren e BE-27).

2 Indeksi i Barazisë Gjinore e mat barazinë gjinore në shtetet anëtare të BE-së në gjashtë fusha: punë, para, njohuri, kohë, fuqi dhe shëndet. Vlera e indeksit paraqitet në një pikë nga 1 deri në 100, ku 1 përfaqëson pabarazi të plotë, ndërsa vlera 100 përfaqëson barazi të plotë.



“Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe e burrave, si dhe e personave me identitete të ndryshme gjinore në të gjitha sferat e sektorit publik dhe atij privat, pozitë të barabartë dhe mundësi të barabarta për t’i ushtruar të gjitha të drejtat dhe liritë dhe shfrytëzimin e njohurive dhe aftësive personale për zhvillimin e shoqërisë, si dhe realizim i përfitimeve të barabarta nga arritjet e punës.”

(UNDP, Profili i barazisë gjinore të Malit të Zi, 2021)

Fusha e parasë e mat pabarazinë gjinore në qasjen në burimet financiare dhe gjendjen ekonomike të grave dhe të burrave dhe arrin në 61.9%. Nën-fusha e parë, burimet financiare që përfshin të ardhurat mujore dhe të ardhurat e grave dhe të burrave, është shumë e ulët 48.2. Nën-fusha e dytë burimet ekonomike mbulon rrezikun nga varfëria dhe shpërndarjen e të ardhurave ndërmjet grave dhe burrave dhe vlera e tij është 79.6.

Fusha e **njohurive** (e mat pabarazinë gjinore në arsim, arritshmërinë në arsim, pjesëmarrjen në arsim dhe aftësim gjatë gjithë jetës) është 53.4. Nën-fusha arritshmëria në arsim matet me dy tregues: përqindja e grave dhe burrave të diplomuar, dhe proporcioni i grave dhe i burrave në arsimin dhe aftësimin formal dhe joformal gjatë gjithë jetës. Vlera e kësaj nën-fushë është 67.1. Nën-fusha e dytë segregimi ka një vlerë prej 42.4 dhe mbulon ndarjen gjinore në arsimin e lartë përmes përqindjes së grave dhe të burrave në radhët e studentëve në fushat e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies, shkencave humane dhe arte.

- Fusha e kohës i mat pabarazitë gjinore në ndarjen e kohës për kujdesin, punët e shtëpisë dhe aktivitetet sociale. Vlera e kësaj nën-fushë është 58.9. Nën-fusha e parë e kujdesit i mat hendeqet gjinore në çdo përfshirje të grave dhe të burrave në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve ose nipërve të tyre, të të moshuarve ose të personave me aftësi të kufizuara, si dhe përfshirjen e tyre në gatim dhe në punët e shtëpisë. Vlera e kësaj nën-fushë është 61.7. Vlera e nën-fushës së dytë të aktivitetet sociale është 56.2.

- Fusha e pushtetit e mat barazinë gjinore në pozitat më të larta vendim-marrëse në sferën politike, ekonomike dhe sociale, dhe vlera e saj është 44.1 Vlera më e ulët është për nën-fushën e fuqisë ekonomike që e mat balancën gjinore në vendim-marrjen ekonomike dhe arrin në 34.7.

- Fusha e shëndetit i mat tri aspekte shëndetësore të barazisë gjinore: statusin shëndetësor, sjelljen shëndetësore dhe qasjen në shërbimet shëndetësore. Vlera e kësaj fushe është 87.9. Nën-fusha shëndeti ka vlerën më të ulët nga të gjitha nën-fushat shëndetësore është 81.1.

Edhe pse ekziston një kornizë ligjore e rrumbullakësuar, të dhënat aktuale tregojnë qartë të dhënat se gratë në Mal të Zi ende po përballen me pabarazi të konsiderueshme në gati të gjitha sferat. Kjo tregon

se ende mungon zbatimi adekuat i ligjeve ekzistuese. Kjo punë nuk kërkon përpjekje nga vendim-marrësit dhe institucionet, por partneritet të ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe OSHC-të, pasi barazia gjinore është çështje e zhvillimit dhe kusht për prosperitetin e çdo komuniteti.

Ka disa sektorë ku gratë, përveç të qenit punonjëse apo anëtare të organeve drejtuese, mbeten të padukshme për sa i përket politikave specifike, si ndryshimi i klimës, energjia dhe transporti. Njohuritë e përgjithshme mbi procedurat e integritit gjinor në administratën publike nuk janë të kënaqshme dhe lënë hapësirë për përmirësime të vazhdueshme që janë qenësore për zbatimin e politikave të informuara gjinore në të gjithë sektorët. Legjislacioni ekzistues e mundëson këtë, por kërkon edhe përmirësime, sidomos kur bëhet fjalë për dispozitat penale.

Kontributi i grave në ekonominë e Malit të Zi

Raporti i UNDP-së në Mal të Zi “Kontributi i grave në ekonominë e Malit të Zi – Shfrytëzimi i punës së kujdesit nga gratë gjatë Covid-19”, (UNDP, 2020) përpiket të vlerësojë kontributin e grave në ekonominë e përgjithshme. Raporti tregon se ndonëse numri i grave në Mal të Zi është pak më i lartë se ai i burrave, gratë kontribuojnë më pak në PBB-në e vendit. Ka dy arsye për këtë: ka numër më të ulët të grave të punësuar dhe punësimi i tyre në sektorë me paga neto më të ulëta.

Sipas të dhënave në raport, gjithsej, kontributi i grave në PBB-në e Malit të Zi arrin në 2,038 miliardë euro, që është regjistrim i PBB-së së vendit në fund të vitit 2018. Andaj, ndonëse numri i grave e tejkalon numrin e burrave, kontributi i tyre në PBB është më i ulët. Sektorët ku gratë kontribuojnë më shumë janë tregtia (332,888,000 €); administrata publike dhe mbrojtja dhe sigurimet shoqërore të detyrueshme (142,776,000 €), dhe arsimiti (132,164,000 €).

Duke qenë se janë të punësuar në sektorët që në mënyrë dominante u ndikuan nga COVID-19, gratë u goditën rëndë nga kjo krizë. Sipas të dhënave (UNDP, 2020), numri i grave të punësuar ka rënë me 5721 për shkak të COVID-19; Shuma e përgjithshme e rënies së pagave neto që janë marrë nga gratë në fund të qershorit kundrejt fundit të shkurtit 2020 ishte 2,347,600 €. Pjesa më e madhe e grave e humbën punën në sektorët e mëposhtëm: tregtia (1,674, që përfaqëson gati 30% të numrit të përgjithshëm të grave që e humbën punën); bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (797), dhe shërbimet e akomodimit dhe të ushqimit (499). Sa i përket rënies së pagave, gratë shënuan rënie të pagave neto në sektorët e mëposhtëm: strehimi dhe shërbimet ushqimore (2,575,200 €); bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (2,016,000 €); tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe i motoçikletave (939,600 €). Gratë fituan më shumë në sektorët e mëposhtëm: kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale; arsimiti; administrata publike; informimi; ndërtimi; furnizimi me ujë; furnizimi me energji elektrike, miniera dhe gurorë. Megjithatë, rënia në pjesën tjetër të sektorëve e ka tejkaluar rritjen, duke rezultuar në një efekt neto prej -2,347,600€.³

3 Profili i Shtetit ESPN Mali i Zi 2020 - 2021

Puna e papaguar

Sipas përkufizimit të pranuar përgjithësisht, kujdesi i papaguar dhe punët e shtëpisë iu referohen të gjitha aktiviteteve që nuk njihen e pranohen dhe që kryhen pa pagesë në një familje, përfshirë kujdesin për të tjerët, si fëmijët ose të moshuarit, dhe përkujdesjen e tërthortë, si gatimi, pastrimi e punë të tjera të shtëpisë. Ashtu sikurse kujdesi me pagesë, kujdesi pa pagesë dhe punët e shtëpisë janë me rëndësi shumë të madhe për mirëqenien e individit dhe të shoqërisë në përgjithësi, pasi ato kontribuojnë në funksionimin më të mirë të të gjithë shoqërisë. Pavarësisht nga rëndësia e tillë për të mirën e përbashkët, praktikisht të gjitha vendet e lënë jashtë politikave të tyre ekonomike kujdesin e papaguar dhe punët e shtëpisë për shkak të supozimit se, për dallim nga procedurat standarde për matjen e punës në treg, kjo është shumë e vështirë të matet.


Për më tepër, është krejtësisht e pajustificuar që këto të dhëna të konsiderohen më pak të rëndësishme për hartimin e politikave ekonomike dhe sociale. Megjithatë, injorimi i këtij lloji të punës së papaguar çon në përfundime krejtësisht të pasakta për pozitën socio-ekonomike të individëve, në veçanti të grave, pasi ato zakonisht shpenzojnë në mënyrë disproporcionale më shumë kohë të angazhuara në këtë lloj pune të papaguar sesa burrat; kjo në fund të fundit ndikon në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në ekonominë me pagesë. Këto çështje rezultojnë në dallime të mëdha në punësim, paga për punën e kryer dhe në përfitimin e pensionit. Sipas të dhënave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për 64 vende që përbëjnë dy të tretat e fuqisë punëtore globale, deri në 16.4 miliardë orë shpenzohen në ditë në punë të kujdesit të papaguar – që është baras me dy miliardë njerëz që punojnë tetë orë në ditë, ditë pa shpërblim. Po të vlerësoheshin shërbime të tilla bazuar në një pagë minimale për orë pune, ato do të arrijnë në shifrën prej 9% të PBB-së globale ose 11 trilion USD (11,000,000,000,000 USD), që barazohet me fuqinë blerëse në vitin 2011.

Raporti i ILO-s “Puna e kujdesit dhe punët e kujdesit për të ardhmen e punës së denjë” përfshin të dhënat e rëndësishme, si më poshtë: gratë kryejnë 76,2 % të orëve të gjithmbarshme të punës së kujdesit të papaguar, tre herë më shumë se burrat. Në raport po ashtu theksohet se puna e papaguar që lidhet me kujdesin dhe punët e shtëpisë është pengesa kryesore që i pengon gratë të hyjnë, të mbeten dhe të avancojnë në fuqinë punëtore. Në vitin 2018, 606 milionë gra në moshë pune, raportuan se nuk ishin në gjendje të punësoheshin dhe të avancoheshin në karrierën e tyre për shkak të punës së kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi. Vetëm 41 milionë burra raportuan të njëjtën gjë. Sipas një raporti të OECD-së, pabarazia gjinore në fushën e punës së papaguar që lidhet me kujdesin dhe punën në shtëpi po ashtu lidhet edhe me hendekun gjinor të pagave. Analizat tregojnë se, në vendet ku gratë shpenzojnë dy herë më shumë kohë se burrat të angazhuara në kujdesin e papaguar dhe punë të shtëpisë, ato fitojnë vetëm 65 % të asaj që fitojnë homologët e tyre burra për punën e njëjtë. Raporti bie në 40% kur gratë shpenzojnë pesëfishin e kohës të angazhuara në kujdesin dhe punët e shtëpisë si burrat (për punonjësit me orar të plotë). Në vendet ku gratë kalojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre të angazhuara në përkujdesje të papaguar dhe punë të shtëpisë, ato kanë më pak gjasa të punësohen, dhe ato që janë aktive në tregun e punës ka më shumë gjasa të kufizohen në punësim me orar të shkurtuar ose në punë joformale dhe të fitojnë më pak sesa moshatarët e tyre burra. Nuk ka të

dhëna për punën e papaguar (përkujdesje dhe punë të shtëpisë) për Malin e Zi.⁴ Puna e papaguar është një sasi e madhe e panjohur në Mal të Zi, duke pasur parasysh mungesën e ndonjë raporti statistikor për kujdesin e papaguar dhe punët e shtëpisë dhe paratë që gjenerohen prej saj.

I vetmi raport që kemi në dispozicion e që ofron një lloj vlerësimi është raporti i UNDP-së në Mal të Zi “Kontributi i grave në ekonominë e Malit të Zi – Shfrytëzimi i punës së kujdesit nga gratë gjatë COVID-19”, (UNDO, 2020). Në raport shtjellohet kontributin e grave në ekonominë malazeze, si dhe çështjet e punës dhe të kujdesit të papaguar gjatë pandemisë Covid-19 dhe ofrohen vlerësime të vlerës së tyre për t’i kuptuar më mirë ndikimet e hershme dhe më të theksuara të krizave tek gratë. Raporti vlerëson ekuivalentin monetar të vlerës së kujdesit të papaguar dhe të punës në shtëpi.

Grafiku 13. Numri i orëve të kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi, sipas aktivitetit (gratë)



Burimi i të dhënave: NDIKIMI I COVID-19 NË POZITËN SOCIO-EKONOMIKE TË GRAVE NË MAL TË ZI (UNDP, 2020)


Analiza ka treguar se: gratë që shpenzojnë deri një orë, i kushtojnë më shumë kohë blerjeve për familjen dhe ekonominë familjare (58%); gratë që shpenzojnë deri në 2 orë, i kushtojnë më shumë kohë pastrimit dhe mirëmbajtjes së shtëpisë së tyre dhe mjedisit rrethues (33.30%); gratë që shpenzojnë deri në 3 orë, i kushtojnë më shumë kohë gatimit dhe servimit të ushqimit (vakteve) (24%); gratë që shpenzojnë deri në 4 orë, i kushtojnë më shumë kohë pastrimit dhe mirëmbajtjes së shtëpisë dhe mjedisit të tyre (9%) dhe gratë që shpenzojnë më shumë se 4 orë, i kushtojnë më shumë kohë kujdesit për fëmijët (15%).

4 UNDP, Profili i barazisë gjinore në Mal të Zi

Vlerësimi i përafërt i ekuivalentit monetar të vlerës së kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi

Ekivalenti monetar i kujdesit të papaguar dhe punëve në shtëpi të kryera nga gratë në Mal të Zi vlerësohet të jetë 122.3 milionë euro vetëm për tre muaj të vitit 2020 (prill, maj dhe qershor), ndërsa ekuivalenti monetar i kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi të kryera nga burrat arrin në 63.5 milionë euro (UNDP; 2020). Kjo do të thotë se gratë bëjnë 90% më shumë punë në fushën e kujdesit të papaguar dhe punëve të shtëpisë sesa burrat. Për më tepër, nëse këto të dhëna parashikohen për 12 muaj, mund të vihet në përfundim se gratë gjeneruan ekuivalentin monetar të kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi prej 489 milionë euro ose 10% të PBB-së, ndërsa burrat gjeneruan 254 milionë euro ose 5% të PBB-së të Malit të Zi për vitin 2019. Parashikohet që, në përgjithësi, burrat dhe gratë gjeneruan 743 milionë euro si ekuivalent monetar i kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi, që arrin deri në 15% të PBB-së së vendit për vitin 2019.

Grafiku 14. Kujdesi pa pagesë dhe punët e shtëpisë të kryera nga gratë dhe burrat, përkatësisht (në €)



Burimi i të dhënave: UNDP COVID-19 NDIKIMI NË POZITËN SOCIO-EKONOMIKE TË GRAVE NË MAL TË ZI

Edhe pse raportet tregojnë se në Mal të Zi është bërë progres i caktuar në lidhje me përmirësimet ligjore dhe institucionale për gratë, ky progres nuk është ende i dukshëm në jetën reale. Pavarësisht se gratë kanë arsim më të mirë se burrat, kjo nuk reflektohet në gjendjen e tyre ekonomike. Stereotipet për rolin e gruas në shoqëri, punë dhe jetën familjare janë ende të forta dhe përbëjnë pengesë për barazinë gjinore. Gratë janë ende të nën-përfaqësuar në pozita drejtuese, kanë paga më të ulëta, janë më shpesh të nën-punësuar për shkak të përgjegjësive shtëpiake dhe kryejnë shumicën e punëve të shtëpisë. E gjithë kjo kontribuon në statusin e tyre të pabarabartë. Duhet bërë shumë punë për të rritur ndërgjegjësimin për statusin dhe rolet e grave në shoqëri, si dhe për të sjellë ndryshime që do të kontribuonin në barazi më të madhe.

Serbia

Hyrje

Ekonomia e kujdesit është gur themel i jetës ekonomike dhe sociale dhe “i referohet punës së paguar të kujdesit që ofrohet nga njerëzit si pjesë e mbijetesës njerëzore, mirëqenies dhe e riprodhimit të fuqisë punëtore”⁷³. Të gjithë preken nga puna e kujdesit, por gratë e mbajnë peshën kryesore të kësaj përpjekjeje të nënvlerësuar. Mirëqenia e individëve dhe e shoqërisë në tërësi varet nga kujdesi i paguar dhe i papaguar, i cili është një komponent kyç për arritjen e rritjes së drejtë ekonomike.

Ekonomia e kujdesit përfshin të gjitha profesionet ku hyn kujdesi për të tjerët, si arsimi, shëndetësia dhe kujdesi social, si dhe kryesisht shërbimet jo formale por me pagesë që jepen në familje. Ekzistojnë dy kategori kryesore të aktiviteteve të kujdesit. E para, ato që përfshijnë detyra të drejtpërdrejta, personalisht, të kujdesit personal (kujdes “i mirëqenies dhe përkujdesjes” ose “lidhjes drejtpërdrejt me personin”) si ushqyerja e një foshnje, kujdesi ndaj një partneri të sëmurë, ndihma ndaj një personi të moshuar me larjen e tij/sak, kryerja e kontrolleve shëndetësore ose udhëzimi i fëmijëve të vegjël. E dyta, ato që përfshijnë aktivitete të kujdesit personal jo ballë për ballë, të njohura si “kujdes jo i lidhjes drejtpërdrejt me personin” ose “punë shtëpiake” që krijojnë kujdes personal. Këto aktivitete përfshijnë pastrimin, gatimin, larjen e rrobave dhe punë të tjera të mirëmbajtjes së shtëpisë. Këto dy kategori të punëve të kujdesit nuk mund të dallohen nga njëra-tjetra, dhe si në shtëpi, ashtu edhe në institucione, ato shpesh mbivendosen kur ndodhin në praktikë.⁷⁴

Marrëdhënia mes tregut të punës dhe ekonomisë të kujdesit

Sa i përket tregut të punës, ekonomia e kujdesit mund të ketë një efekt të konsiderueshëm. Për shembull, ndonëse më shumë gra kanë hyrë në fuqinë punëtore në dekadat e fundit, ka pasur një kërkesë në rritje për shërbime të kujdesit, si: kujdesi për fëmijët dhe kujdesi për të moshuarit. Kjo ka çuar në rritjen e sektorit të kujdesit si një burim kryesor punësimi. Megjithatë, shumë punonjës të kujdesit paguhen me paga të ulëta dhe u mungojnë përfitimet si sigurimi shëndetësor ose pushimi me pagesë. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të nënvlerësimit të punës së përkujdesjes, e cila shpesh shihet si “punë e grave”, dhe për këtë arsye konsiderohet më pak e rëndësishme se format e tjera të punës.

Shpesh puna e papaguar e grave ka qenë pengesë për pjesëmarrjen e tyre të plotë në tregun e punës. Kur gratë pritet ta marrin përsipër pjesën më të madhe të punës së papaguar, ato shpesh kanë më pak kohë për t'i kushtuar punës së paguar ose shkollimit. Kjo mund të rezultojë në paga më të ulëta dhe më pak mundësi për avancim në karrierë. Për më tepër, punëdhënësit mund të diskriminojnë gratë që ata i perceptojnë se ka të ngjarë të marrin pushim për t'u kujdesur për anëtarët e familjes ose që ata besojnë se mund të jenë më pak të përkushtuara në karrierën e tyre. Megjithatë, ekzistojnë mënyra për të trajtuar këtë çështje. Politikat që mbështesin lejen prindërore të paguar, kujdesin e përballeshëm për fëmijët dhe aranzhimet fleksibile të punës, mund t'i ndihmojnë gratë që t'i balancojnë përgjegjësitë e tyre të punës së papaguar dhe të paguar. Për më tepër, përpjekjet për t'i sfiduar normat gjinore dhe për t'i inkurajuar burrat që të marrin më shumë përgjegjësi përkujdesjeje, mund të ndihmojnë në heqjen e barrës së punës së papaguar nga gratë.

Ekuivalenti i një pune me kohë të plotë (8 orë në ditë) shpenzohet nga dy miliardë njerëz çdo ditë në industrinë e kujdesit të papaguar, sipas vlerësimeve që bazohen në të dhënat e anketës së përdorimit të kohës nga 64 vende. Këto aktivitete do të kontribuonin me 9% në PBB-në globale nëse do të vlerësoheshin sipas standardeve të tregut të punës, ose nëse do t'u paguhej paga minimale për orë pune. Të njëjtat burime pohojnë se gratë i kryejnë tre të katërtat e kësaj pune në nivel global dhe nuk ekziston asnjë shtet i vetëm ku burrat e kryejnë më shumë këtë lloj pune sesa gratë.⁷⁵


Statistikat zyrtare

Sipas të dhënave të Institutit Republikan të Statistikave për përdorimin e kohës në Republikën e Serbisë nga viti 2021, një banor i Republikës së Serbisë shpenzon mesatarisht tre orë (3:08) në punë të paguar. Megjithatë, gratë punojnë pak më pak se dy orë e gjysmë (2:23), ndërsa burrat punojnë një orë e gjysmë më shumë (3:57), ose gati katër orë. Kur bëhet fjalë për punësimin e paguar dhe të papaguar, popullsia shpenzon të njëjtën kohë (3:08), megjithëse ka dallime të konsiderueshme gjinore.⁷⁶


Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore në Republikën e Serbisë për vitin 2022, të realizuar nga Instituti Republikan i Statistikave, gratë dominojnë me praninë e tyre në fushat e mëposhtme në tregun e punës. Kështu, në fushën e aktiviteteve financiare dhe të sigurimeve kemi 32 mijë gra krahasuar me 17,5 mijë burra, në fushën e veprimtarive profesionale, shkencore, inovative dhe teknike kemi 57,6 mijë gra kundrejt 54,7 mijë burra, pastaj në fushën e arsimit kemi 136,3 mijë gra të punësuar krahasuar me 45,1 mijë burra. Gjithashtu, gratë dominojnë për nga punësimi në fushën e shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale, ku kemi 133 mijë gra krahasuar me 38,8 mijë burra. Në aktivitetet e tjera shërbyese kemi 29,4 mijë gra kundrejt 22,9 mijë burra, ndërsa në veprimtarinë e demokracive si punëdhënëse kemi 7,9 mijë gra kundrejt 1,4 mijë burra.⁷⁷

Analiza e të dhënave të anketës

Grafiku 15. Të anketuarit sipas gjinisë




Grafiku 16. Të anketuarit sipas moshës




Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 11% e tyre janë në grupin 15-24, 33% në grupin 25-32, 44% në grupin 33-45, 8% në grupin 46-54, 3% në grupin grupi 54-65 dhe 1% në grupin 65+.

Grafiku 17. Të anketuarit sipas statusit të punësimit



Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 79% janë të punësuar, 19,7% të papunë, 3% e të anketuarve kanë thënë se janë të papunë dhe se nuk po kërkojnë punë. Për më tepër, 42,2% e të anketuarve thanë se janë duke punuar në sektorin publik, dhe 57,8% në sektorin privat.

Grafiku 18. Të anketuarit sipas shkollimit




Kur është fjala për shkollimin, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 68% e të anketuarve e kishin të kryer shkollimin universitar, 30% shkollimin e mesëm, 2% shkollimin fillor dhe nuk kemi pasur të anketuar pa-shkollë.

Në pyetjen pse nuk po kërkojnë punë, 4% e të anketuarve kanë thënë se nuk ka punë, 6% kanë thënë se nuk duan të punojnë, 20% kanë thënë se ka punë por me paga të ulëta, 4% e të anketuarve thanë se nuk kanë kohë për të punuar për shkak të punëve të shtëpisë/kujdesit ndaj fëmijëve/kujdesit ndaj të moshuarve ose për shkak të mungesës së transportit, ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin tjetër (në atë rast shumica prej tyre janë studentë të punësuar).

